



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Njësine Administrative Dajt”

DOKUMENTI 14

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
(TEMATIK)

“NJËSIA ADMINISTRATIVE DAJT”

Tiranë,2023

📖 PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3 - 7
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3 - 3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve.....	3 - 6
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni I Auditimit.....	6 - 7
II	HYRJA	7 - 9
	a. Objektivat e auditimit.....	
	b. Qëllimi i auditimit.....	
	c. Identifikim i çështjes.....	
	d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	
	e. Përgjegjësitë e Audituesve.....	
	f. Kriteret e vlerësimit	
	g. Standardet e auditimit.....	
	h. Metodatat e auditimit	
	i. Dokumenti i auditimit.....	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.	9 - 35
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	9 - 10
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	10 - 35
2.1	<i>Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK.....</i>	10 - 35
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMI.....	35 - 38

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

I.1-Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim* KLSH), në periudhën nga data 22.9.2022 deri në datën 30.3.2023 realizoi auditimin mbi përputhshmërinë (tematik) në subjektin Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë, sipas programit të auditimit nr. 796/1, datë 4.10.2022 (me ndryshime) të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën nga data 01.01.2019 deri me datë 30.8.2022.

Auditimi u krye me zgjedhje për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), janë konstatuar mangësi dhe parregullsi, më lidhje meverifikimin e procedurave të ndjekura për saktësinë e lëshimit të AMTP-ve dhe konfirmimi dhe pozicionimi i planvendosjeve të tyre për regjistrim të AMTP në Drejtoria Vendore ASHK Tirana Rurale.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione se në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit mbi Përputhshmërinë, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ, të cilat i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në katër kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1	Në 1 rast nga Njësia Administrative Dajt, është pranuar kërkesa e z. H. D për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, pa verifikuar formularin nr.6, nëse ngastra me emërtimin popullor "Linz" rreshti i gjashtë dhe shtatë në AMTP, me sipërfaqe 4500 m ² dhe 1270 m ² në llojin e pasurisë "Arë", përputhet me AMTP-në me nr.Akti 128, datë 08.04.2003, si dhe si dhe pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative për	<i>I mesëm</i>	10-35	Njësia Administrative Dajt, të kërkoje pranë DV ASHK Rurale 1, anulimin e regjistrimit të dërguar me shkresën nr. 552/1, datë 19.02.2021, për regjistrimin e pasurisë "pyll" në emër të z. H. D, ku pasuria nr Pasurie 505/361, regjistruar në vol.64, faqe 11, Z.K. 2460 nga lloji i pasurisë "pyll" më sipërfaqe 2250 m ² , Fshati Linz, të rikthehet në pasuri "shtet"

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Fshatin Linz, hartën e ish-kooperativës bujqësore të shk. 1:5000, hartën e shk. 1:2500, dhe librin e ngastrës, për të provuar vertetësin e llojit të pasurisë.			
2	Në 1 rast nga Administratori i Njesisë Administrative Dajt është dërguar AMTP-së “Dublikatë” direkt për regjistrim pa kaluar më parë në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë, ku në foramtin e formalit të AMTP-së Dublikatë mungon miratimi i Kryetarit të Bashkisë Tiranë, që do të thotë së, në bazë të nenit 109, të Ligjit nr. 44/2015 “Për Kodin e Proedurës Administrative” është një akt administrativ i paligjshëm, ku paligjshmëria është rezultat i miratimit të AMTP-së Dublikatë në kundërshtim me ligjin material.	<i>I lartë</i>	<i>10-35</i>	Në gjitha rastet për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të pronësië të rinjë mbi tokën bujqësore, kur AMTP-ja do të plotësohet “Dublikatë”, Njësia Administrative Dajt duhet të dërgoj AMTP-në për verifikim dhe miratim në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.
3	Në 6 raste nga Njësia Administrative Dajt është përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plani i rilevimit nuk është hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke mos përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”, në kundërshtim me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.	<i>I mesëm</i>	<i>10-35</i>	Njësia Administrative Dajt të përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plan rilevimit të hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke përmbushur standardet teknike të përcaktuara dhe në modelet e akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale.
4	Nga Njësia Administrative Dajt, është pranuar kërkesa e z. S. M për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa verifikuar më parë vlefshmërinë e ngastrës me emërtimin popullor “ullishte”, që bazuar në “kthim përgjigje të DV ASHK Tirana Rurale 1, rezulton në llojin e pasurisë tokë “Pyll”.	<i>I mesëm</i>	<i>10-35</i>	Njësia Administrative Dajt, para se të dërgoj AMTP-së dhe plan rilevimit për regjistrim, duhet që Specialisti i ZAMIT-së. të verifikoj formularin nr.6, librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991 për vlefshmërinë e ngastrës për zërin kadastral të pasurisë.
	Nga auditimi rezulton se Njësia Administrative Dajt në vazdimësi ka llogaritur si të ardhur nga tatimi për një rrënjë ullinjë të barabartë me një sipërfaqe nga 80 m ² deri 120 m ² çfarë do të thotë se 30 rrënjë ullinjë që posedon Z. M. E është e barabartë më (max.) 3600 m ² , (120 m ² x 30 rrënjë ullinjë = 3600 m ²), ndërsa kërkesen e Z. R. E e është miratuar me sipërfaqe 5960 m ² sipas Plan rilevimit i hartuar me datë 15.02.2021	<i>I mesëm</i>	<i>10-35</i>	Nga Njësia Administrative Dajt në të gjitha rastet të përdorë një standart në llogaritjen e të ardhurave nga tatimi për një rrënjë ullinjë të barabartë me një sipërfaqe nga 80 m ² deri 120 m ² .

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	nga topografi i Njesisë Administrative Dajt i konfirmuar nga Përgjegjesi i ZMMT dhe i miratuar nga Administratori i Njesisë Administrative Dajt.			
5	Në 10 raste , nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore më shumë se sa është përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Komunës duke tejkalluar normen për frymë, në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe me ligjit 20/2020 dhe ligjin nr.111/2018 “Për Kadastrën”.	<i>I mesëm</i>	10-35	Nga Njësia Administrative Dajt në të gjitha raste para se të përcjellje dokumentacioni për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë normën për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.
6	Në 1 rast , përfituesi i AMTP-së, i plotësuar në emër të znj. N. B nga ish-komisioni i ndarjes së tokës, Fshati Tufinë, nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore, bazuar në certifikatën e gjendjes familjare të administruar në dosje. rezulton se familja bujqësore nuk kanë qenë banor në territorin e i fshatit Tufinë por është banor i fshatit Zall-Bastarë	<i>I mesëm</i>	10-35	Nga Njësia Administrative Dajt në të gjitha raste para se të përcjellje dokumentacioni për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë legjitimitetin e AMTP-së në lidhje me përfitimin e tokës bujqësore sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore.
7	Në 4 raste , nga ana e specialistit të ZAMIT-t të Njesisë Administrative Dajt nuk është verifikuar pasuria në terren por është referuar plan-rilevimit i përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit i është nuk ka saktësuar pasurisë sipas terrenit, por është referuar hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1. duke copëzuar pasurinë nr.364/4 në tre pasuri të tjera “shtet” krejtësisht të pashfrytëzueshëm duke marr një konfigurim krejtësisht të ndryshëm nga fragmenti i hartës kadastrale, në kundërshtim me nenit 36, pika "b", të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.	<i>I mesëm</i>	10-35	Nga specialisti i ZAMIT-t të Njësia Administrative Dajt në të gjitha rastet para se të miratoje plan rilevimit e përgatitur nga topografi me licencë të verifikohet pasuria sipas terrenit dhe të shoqërohet me deklarat noteriale sipas rastit.
6	Në 1 rast mungon statusi juridik i pronës të pretenduar nga z. S. M e konfirmuar nga DV ASHK Rurale 1, për pasurinë nr. 322 për llojin e pasurisë (zërin kadastral), në çfarë volumi dhe faqe është regjistruar pasuria, si dhe në çfarë emëri figuron e hapur kartela e pasurisë së paluajtshme. Nga ana e specialistit të ZAMIT-së Njësia Administrative Dajt nuk është verifikuar në librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991, për ngastren me pasurinë nr.	<i>I lartë</i>	10-35	Nga specialisti i ZAMIT-t të Njesisë Administrative Dajt, të verifikoj AMTP-në, ku sipërfaqia e tokës që kalohet për regjistrim, duhet të përmbushë, njëkohësisht, t’i përkasë një prej zërave të tokës bujqësore me qëllim konsolidimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi tokën bujqësore.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	322 me zë kadastral “truall” me sipërfaqe 20700 m ²			

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Ne e kemi kryer auditimin tonë në subjektin Njësia administrative Dajt Bashkia Tiranë, nëpërputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e Raport Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendim nr. 66, datë 23.06.2020 edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit.

Nga auditimi i përputhshmërinë, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), janë konstatuar mangësi dhe parregullsi, më lidhje meverifikimin e procedurave të ndjekura për saktësinë e lëshimit të AMTP-ve dhe konfirmimi dhe pozicionimi i planvendosjeve të tyre për regjistrim të AMTP në DV ASHK Tirana Rurale 1, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë *materiale por jo të përhapura*, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një *opinionit të kualifikuar*, paraqitura tek baza për opinion:

Baza për opinionin

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Njesisë Administrative Dajt Bashkia Tiranë, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, ku:

-Në 3 raste pasuritë e përfituar me anë të AMTP-së bie mbi pasuri “pyll”, që do të thotë se nga Njësia Administrative Dajt, është pranuar kërkesa, për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, (AMTP-së) pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Dajt hartën e shk. 1:5000 dhe librin e ngastrëspara vitit 1991.

-Në 10 raste, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore për normë për frymë më shumë se sa është përcaktuar norma për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.

-Në 5 raste, përfituesi i AMTP-së nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore, bazuar në certifikatën e gjendjes familjare të administruar në dosje.

-Në 6 raste, plani i rilevimit i hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, nuk përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”.

-Në 4 raste, nga ana e specialistit të ZAMIT-t të Njesisë Administrative Dajt nuk është verifikuar pasuria në terren por është referuar plan-rilevimit i përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit i është nuk ka saktësuar pasurisë sipas terrenit, por është referuar hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1.

-Në 1 rast, është plotësuar AMTP “Dublikatë” nga Njësia Administrative Dajt dhe e dërguar direk për regjistrim pa u miratuar më parë nga Sektori i AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.

-Në të gjitha rastet, në dosje mungon e administruar vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Njesisë Administrative Dajt:

Strukturat drejtuese të Njesisë Administrative Dajt, janë përgjegjëse për konfirmimin e AMTP-ve dhe konfirmimin dhe miratimin e plan rilevimit për regjistrimin në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës, si dhe kryerjen e shërbimeve ndaj publikut brenda afateve ligjore, me qëllim rritjen e besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve. Stafi drejtues është përgjegjës për drejtimin e institucionit, në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse procedurat e konfirmimit të AMTP-ve dhe konfirmimin dhe miratim e plan rilevimit për regjistrimin të miratuara nga Njesisë Administrative Dajt, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse regjistrimi i pasurive dhe transaksionet mbi pasuritë, e regjistruara janë kryer, në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe kërkesat ligjore. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e aktivitetit të institucionit gjatë të periudhës objekt auditimi, duke i përshkruar në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor, nuk lejon vënien në dispozicion të tyre, për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

1. Përshkrim i auditimit.

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit Tematik të Auditimit nr. 796/1, datë 4.10.2022 (me ndryshime) të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me afat auditimi nga data 22.9.2022 deri në datën 30.3.2023, në subjektin Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë u krye auditimi “Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për saktësisë së lëshimit të AMTP-ve dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK”, për periudhën nga 01.01.2019 deri me datë 30.8.2022, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K. GJ Përgjegjës Grupi.**
2. **S. S**
3. **P. GJ**

a- Objektivat dhe qëllimi:

Objektivat: Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK.

Qëllimi: Raportimi dhe evidentimi i gjetjeve, nxjerrja e konkluzioneve mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

b- Identifikimi i çështjes: Ky Raport Përfundimtar Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të Njësisë Administrative Dajt, Bashkia Tiranë dhe përgjegjësive të tyre, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, përsa i përket procedurës së ndjekur për verifikimin e procedurave të ndjekura për e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK. Në bazë të gjykimit dhe skepticizmit profesional, për qëllimet e auditimit, audituesit kanë bërë vlerësimin, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe janë vlerësuar evidencat e grumbulluara përsa i përket besueshmërisë, mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë.

Në lidhje me verifikimin e procedurave të mësipërme, nga Grupi i Auditimit u shqyrtuan dokumentacioni tekniko-ligjor, i AMTP-ve, formulari 6, libri kadastral i fshatrave, hartat kadastrale me shk: 1:5000 dhe si dhe harta me shkallë 1:2500, plan rievimet deklarata noteriale, si dhe korrespondencat shkresore me institucionet përkatëse.

c- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar.

Strukturat drejtuese dhe punonjësit e subjektit Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë janë autoriteti që konfirmojnë për çdo pasuri që gjendet në juridiksionin territorial. Për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim, të cilët mbajnë përgjegjësi për veprimet apo mosveprimet në lidhje me zbatimin e procedurës për verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e lëshimit të AMTP-ve, konfirmimin, saktësimin dhe pozicionimin planvendosjeve të tyre për regjistrimin në DV ASHK Rurale 1, në shkëlqje të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe në referim të VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”.

d- Përgjegjësitë e Audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim në lidhje me vlerësimin e verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e lëshimit të AMTP-ve, konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerrja nga evidencat e mbledhura. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

e- Kriteret e vlerësimit.

- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

- Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar.

- Ligji nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”.

- Ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, të ndryshuar.

- Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- Ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.
- Ligji nr.20/2020, datë 5.3.2020 “Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore”.
- VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”.

f- Standardet e auditimit:

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.107, datë 08.08.2017, e ndryshuar nr. 63, datë 22.06.2020 dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

i- Metodatat e auditimit:

Përraritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodatat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

-Metoda "Testim hap pas hapi: Përfaqëson veprime specifike që ndiqen brenda sistemit nga origjina deri në veprimin e fundit. Në këtë rast një numër i caktuar praktikash janë përzgjedhur për të parë se si njësia publike i është përmbajtur procedurave të caktuara.

-Metoda e ekzaminimit: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të Audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e veprimeve.

-Metoda e ekzaminimit kryq: Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve.

-Metoda e inspektimit fizik: Me anë të kësaj metode audituesit kanë verifikuar gjendjen fizike të dokumenteve të ndryshme në lidhje me çështjet nën auditim.

-Metoda e intervistimit: Është konsideruar si një nga metodatat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patur përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacional gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësive të audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashkrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përfitohen nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

-Metoda e testimit të detajuar: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

j. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe

rregullatore. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit. Auditimi është në fazën ku nga subjekti audituar (*Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë*), ka paraqitur kundërshtitë me shkresën nr. 850/3prot, datë 12.5.2023(*prot KLSH nr. 796/16, datë 17.5.2023*), mbi Projekt Raport Auditimin, për të cilën grupi i KLSH pasi analizojë me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizëm, mori në konaidetatë rastet të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion. Ndërsa rastet e tjera të cilat nuk kishin argumentin e mjaftueshëm ligjorë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi (Tematik), i cili i përcillet subjektit për njohje dhe marrjen e masave për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i Përgjithshëm:

Nga të dhënat e paraqitur nga Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë për konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, në zbatim të urdhrat të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 “Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administratimin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore”, i ndryshuar, në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Pika 2.1. Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se, Komuna Dajt sot Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë ka ndarë tokë sipas ligjit nr. 7501 “Për Tokën” për familje të cilët kanë qenë banorë të ish- NB dhe Kooperativave bujqësore me datë 19.07.1991 për **13 fshatra** të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Fshati	Sip tokës Gjithsej (ha)	Tokë e ndarë në pronësi	Subjekte të trajtuara me AMTP	Norma për frymë në m ²
1	Qafmollë	51	44.4	51	1500
2	Shkallë	67.8	54.9	105	1500
3	Murth	75.6	55.8	58	2000
4	Darshen	166	128.4	153	2300
5	Selbe	150.6	126	118	2000
6	Prisk e Madhe	324.289	224.08	407	1750

Nr	Fshati	Sip tokës Gjithsej (ha)	Tokë e ndarë në pronësi	Subjekte të trajtuara me AMTP	Norma për frymë në m ²
7	Surrel	170.4605	115.32	212	1400
8	Lanabregas	119.9241	114.52	116	1400
9	Linz	123.07	156.7	501	1100
10	Tufinë	114.3794	95.38	241	1140
11	Tujan	73.99	27.2	65	900
12	Brar	133.905	49.28	96	950
13	Ferraj	110.79	102	73	2300
	Totali	1681.808	1293.98	2196	

Burimi i të dhënave NJ/Administrative Dajt.

Nga të dhënat e paraqitur nga Njësia Administrative Dajt për konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, kjo në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 “Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administratimin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore” (i ndryshuar), në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, rezultoi si më poshtë:

Për vitin 2019, sipas kërkesave të subjekteve dhe individëve nga Njësia Administrative Dajt janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **18 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK, si më poshtë:

	Emri/Mbiemër	Protokolli	Datë	Tipologjia
1	H. A	248/1	25.03.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
2	B. G	507/1	19.02.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
3	B. GJ	562/1	18.03.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
4	B. M	694/1	19.03.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
5	B. H	855/1	28.03.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
6	H. P	1095/1	26.04.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
7	N. M	1347/1	20.05.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
8	G. D	1479/1	27.08.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
9	XH. H	1820/1	04.09.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
10	I. D	2693/1	22.10.2019.	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
11	B. XH	2712/1	23.10.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
12	V. F	2881/1	08.11.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
13	S. F	2882/1	08.11.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
14	R. GJ	2888/1	08.11.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
15	S...	2967/1	18.11.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
16	S. D	3011/1	20.11.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë

	Emri/Mbiemër	Protokolli	Datë	Tipologjia
17	S. S	3017/1	20.11.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
18	XH. T	3214/1	05.02.2019	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë

Burimi i të dhënave NJ/Administrative Dajt.

Për vitin 2020, nga Njësia Administrative Dajt janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **37 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK, si më poshtë:

	Emri/Mbiemër	Protokolli	Datë	Tipologjia
1	XH. SH	13/1	08.01.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
2	M. L	129/1	14.01.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
3	A. F	185/1	20.01.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
4	F. C	206/1	22.01.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
5	H. T	325/1	05.02.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
6	P. M	330/1	06.02.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
7	SH. K	333/1	06.02.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
8	G. G	436/2	30.07.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
9	M. A	1049/1	19.05.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
10	B. H	1083/1	20.05.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
11	S. F	1429/1	17.06.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
12	V. F	1430/1	17.06.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
13	H. H	1495/1	24.06.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
14	A. A	1499/1	24.06.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
15	V. M	1650/1	27.07.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
16	D. GJ	1683/1	09.07.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
17	B. SH	1882/1	28.07.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
18	K. K	2093/1	11.08.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
19	B. L	2373/1	23.09.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
20	A. Q	2417/1	10.09.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
21	A. T	2500/1	23.09.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
22	A. L	2512/1	14.10.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
23	A. D	2513/1	29.09.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
24	F. M	2542/1	19.11.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
25	D. B	2585/1	25.09.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
26	Y. K	2680/1	06.10.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
27	A. V	2755/1	13.10.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
28	F. M	2830/1	15.10.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
29	XH. Z	2855/1	21.10.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
30	L. Q	2980/1	19.11.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
31	G. T	2994/1	02.11.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
32	L. XH	3335/1	10.11.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
33	P. J	3549/1	27.11.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
34	SH. B	3882/1	31.12.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
35	K. T	3884/1	31.12.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
36	A. L	3885/1	31.12.2020	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
37	A. D	3887/1	02.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë

Burimi i të dhënave NJ/Administrative Dajt.

Për vitin 2021, nga Njësia Administrative Dajt janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **7 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK, si më poshtë:

	Emri/Mbiemër	Protokolli	Datë	Tipologjia
1	R. D	162/1	26.01.2021	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
2	SH. T	163/1	22.01.2021	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
3	A. M	151/1	03.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
4	A. C	152/1	05.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
5	F. T	321/1	05.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë
6	SH. SH	421/1	19.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt Bashkisë

Burimi i të dhënave NJ/Administrative Dajt.

Për 61 dosjet e plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjorë nga Njësia Administrative Dajt dhe të dërguara në Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, kjo e fundit me shpresë ka bërë njoftim Njesisë Administrative Dajt për dosjet e plotësuara të cilat janë nisur drejt ASHK për regjistrim, për **42 dosje**.

Nga të dhënat e rezultojnë se Njësia Administrative Dajt për periudhën objekt auditimi janë dërguar dosje të plotësuara për regjistrim drejt ASHK, **25 praktika** si më poshtë:

	Emri/Mbiemër	Protokolli	Datë	Tipologjia
1	A. F	2047/1	08.08.2019	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
2	N. D	2048/1	13.08.2019	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
3	B. I	2185/1	25.08.2020	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
4	T. T	2606/1	30.09.2020	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
5	R. GJ	3633/1	04.12.2020	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
6	L. M	3646	03.12.2020	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
7	B. I	3648/1	04.12.2020	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
8	B. B	3746/1	24.12.2020	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
9	V. SH	3756/1	10.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
10	S. M	3802/1	22.12.2020	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
11	F. I	51/1	12.07.2021	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
12	G. I	184/1	03.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
13	Ç. I	320/1/2	04.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
14	G. B	323/1	03.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
15	H. B	547/1	19.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
16	Z. B	548/1	23.03.2021	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
17	SH. B	549/1	19.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
18	R. E	550/1	19.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
19	S. H	551/1	19.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
20	H. D	552/1	19.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
21	M. J	553/1	19.02.2021	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
22	Y. K	2679/1	05.10.2020	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
23	Z. K	3159/1	13.11.2020	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
24	K. B	3337/1	19.11.2020	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK
25	S. C	3803/1	22.12.2020	Dërgim dokumentacioni drejt ASHK

Burimi i të dhënave NJ/Administrative Dajt.

Titulli gjetjes: *Problematikat e konstatuara në dërgimin e AMTP për regjistrim në ASHK.*

Situata

Nga të dhënat e rezultojnë se Njësia Administrative Dajt për periudhën objekt auditimi, ka dërguar AMTP për regjistrim drejt ASHK-së, duke mos qenë i legjitimuar për të përfutuar tokë bujqësore, me si më poshtë:-

-Në 3 raste, pasuritë e përfutuar me anë të AMTP-së bie mbi pasuri “pyll”, që do të thotë se nga Njësia Administrative Dajt, është pranuar kërkesa, për dërgimin e AMTP-së për

regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, (AMTP-së) pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Dajt hartën e shk. 1:5000 dhe librin e ngastrëspara vitit 1991.

-Në 10 raste, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore për normë për frymë më shumë se sa është përcaktuar norma për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.

-Në 6 raste, plani i rievimit i hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, nuk përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”.

-Në 4 raste, nga ana e specialistit të ZAMIT-t të Njesisë Administrative Dajt nuk është verifikuar pasuria në terren por është referuar plan-rievimit i përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit i është nuk ka saktësuar pasurisë sipas terrenit, por është referuar hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1.

-Në 1 rast, është plotësuar AMTP “Dublikatë” nga Njësia Administrative Dajt dhe e dërguar direk për regjistrim pa u miratuar më parë nga Sektori i AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.

-Në të gjitha rastet, në dosje mungon e administruar vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore

Kriteri

Në kundërshtim me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1, datë 02.07.2016 “Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësia Administrative nën administrativin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore”; me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”; me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar; ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”, i ndryshuar; ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar me ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe Urdhrin nr. 39203/1, datë 17.10.2019 “Për një shtesë në Urdhrin nr. 26474/1, datë 02.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë “Për delegim kompetencave nga

Ndikimi/efektiviteti	Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë”.
	Parregullsia në dokumentacionin shoqërues të AMTP për regjistrim në kundërshtim me akte ligjore.
Shkaku	Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.
Rëndësia	I lartë
Për këtë rekomandojmë	Njësia Administrative Dajt Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 1, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Dajt.

1- Praktika e qytetarit z. K. K

Me shkresën nr. 2093/1, datë 11.08.2020 NJA Dajti është drejtuar z. E. B me funksion Drejtori Drejtorisë së përgjithshme të Objekteve në bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), për dërgim dokumentacion për regjistrim fillestar të pasurisë të fituar me ligjin nr. 7501.

Me kërkesë datë 10.08.2020, prot NJA Dajt nr. 2093, qytetari z. K. K nga fshati Shkallë, ZK 3381, NJA Dajt është kërkuar plotësimi dokumentacionit për regjistrimin e AMTP nr. 68, datë 13.11.1992, së përfutur sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” i ndryshuar.

Sipas kërkesës qytetari kërkon të pajiset me certifikatë pronësie si vijon:

a- Për ngastrën me emërtimin popullor “Zalli Dukjet”, rreshti i dytë në AMTP për sipërfaqen 1200 m², sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 19.11.2019. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 45/6 me sipërfaqe 1200 m² në ZK 3381 fshati Shkallë.

b- Për ngastrën me emërtimin popullor “NerLoma”, rreshti i tretë në AMTP për sipërfaqen 1080 m², sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 19.11.2019. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 374 me sipërfaqe 1080 m² në ZK 3381 fshati Shkallë.

c- Për ngastrën me emërtimin popullor “Urza”, rreshti i katërt në AMTP për sipërfaqen 900 m², sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 19.11.2019. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 384 me sipërfaqe 900 m² në ZK 3381 fshati Shkallë.

d- Për ngastrën me emërtimin popullor “Kazhnjeti”, rreshti i peste në AMTP për sipërfaqen 1070 m², sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 19.11.2019. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 422 me sipërfaqe 1070 m² në ZK 3381 fshati Shkallë.

e- Për ngastrën me emërtimin popullor “Ballmira”, rreshti i gjashtë në AMTP për sipërfaqen 1250 m², sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 19.11.2019. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 413 me sipërfaqe 436 m² dhe me pasurinë nr. 414 me sipërfaqe 814 m² në ZK 3381 fshati Shkallë.

Nga të dhënat e mësipërme nga qytetari z. K. K është kërkuar regjistrimi pasurisë së fituar sipas ligjit 7501 (tokë) për sipërfaqen 5500 m².

Referuar dokumentacionit në dosje rezulton se:

Sipas shkresës datë 28.3.2019 ish- ZVRPP (sot ASHK), informon se sipas aplikimit nr. 24855, datë 18.03.2019 se në arkiv është depozituar AMTP nr. 68, datë 13.11.1992 për sipërfaqen

totale 7110 m², e shoqëruar kjo me gjendjen juridike të pronave sipas planrivelimit, e cila rezulton të jetë e gjitha shtet, konkretisht: kartela e pasurisë nr. 374, vol 3, fq 64; nr. 384, vol 3, fq 67; nr. 422, vol 3 fq 85; nr. 414, vol 3 fq 83.

Sipas certifikatës së gjendjes civile 1991, familja përbëhet nga tre anëtarë dhe në referencë të fshatin Shkallë ish- Komuna Dajt, norma për frymë është 1500 m², duke i korresponduar një sipërfaqe të ligjshme prej 4500 m² dhe jo sa është plotësuar AMTP me sipërfaqe 7110 m².

Konkluzion: Referuar sipërfaqes së përgjithshme të kësaj AMTP-je e cila është 7110 m² dhe gjendjes familjare 01.08.1991, ky subjekt ka tejkallim të normës për frymë, në këto kushte AMTP-ja me nr. nr. 68, datë 13.11.1992, është e pavlefshme.

Plan rilevimet janë përgatitur dhe hartuar nga topografi i Njësisë Administrative Dajt z. B. R dhe jo nga topografi i licencuar, në kundërshtim me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

Mungon relacioni shpjegues se si është përfituar tokë bujqësore nga kryefamiljari K. K.

2- Praktika e qytetarit z. XH. N

Me shkresën nr. 2501/1, datë 22.09.2020 NJA Dajti është drejtuar z. E. B me funksion drejtori drejtorisë së përgjithshme të objekteve në bashkëpronësi, administrimit të nja-ve dhe emergjencave civile (DANJ-ve/AMTP-ve) për dërgim dokumentacion për regjistrim fillestar të pasurisë të fituar me ligjin nr. 7501.

Me kërkesë datë 17.9.2020, prot NJA Dajt nr. 2501, qytetari z. XH. N nga Fshati Tufinë, ZK 3426, NJA Dajt është kërkuar plotësimi dokumentacionit për regjistrimin e AMTP nr. 81, datë 04.7.1992, së përfituar sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” i ndryshuar.

Referuar të dhënave të gjendjes civile shtetasi XH. N. është i ardhur nga Vithkuq Korçë me datë 13.05.1996 dhe certifikatë lëshuar sipas gjendjes civile viti 1996.

Sipas kërkesës qytetari kërkon të pajiset me certifikatë pronësie si vijon:

a- Për ngastrën me emërtimin popullor “Kumia”, rreshti i parë në AMTP për sipërfaqen 2800 m² lloj pasurisë “Arë”, sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 27.9.2020. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 52/2,53/2 me sipërfaqe 2800 m².

b- Rreshti i pesë të AMTP për 14 rrënjë “Ullinj”, për sipërfaqen 1400 m², sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 29.9.2020. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 664 në ZK 3426 fshati Tufinë.

Konkluzioni: Nga ish-komisioni i ndarjes së tokës fshati Tufinë është plotësuar me tokë bujqësore familja Nesimi, duke mos qenë banorë me 1 gusht 1991, në kundërshtim me ligjin nr.7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar dhe me Vendimin nr. 255 datë 02.08.1991 “Për Kriteret e Ndarjes së Tokës Bujqësore” i ndryshuar me VKM nr.296, datë 07.07.1992.

Dy Plan rilevimet janë përgatitur dhe hartuar nga topografi i Njësisë Administrative Dajt z. B. R dhe jo nga topografi i licencuar, në kundërshtim me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

3- Praktika e qytetarit z. Q. L

Me shkresën nr. 5451, datë 28.7.2020 ASHK Tirana Rurale nr. 1, kërkon nga NJA Dajt në lidhje me aplikimin nr. 17205, datë 21.7.2020, si më poshtë vijon:

Nga qytetari është kërkuar rifreskim të kartelave të pasurisë të ndodhura në ZK 3550 (Surrel), vol 4, fq 46 me nr. pasuri 157/4 me sipërfaqe 1500 m² e llojit “arë”, të ZK 3350, vo; 3, fq 67 të pasurisë 174/3 me sipërfaqe 3000 m² e llojit “arë”, ZK 3350, vol 3 fq 58 të pasurisë nr. 166/1 me sipërfaqe 2000 m² e llojit “arë”. Të gjitha këto pasuri janë të regjistruara në emër të familjes Q. L me nr. akti 63 dhe nr. akti 9.

Në arkivën e ASHK nuk gjendet dokumentacioni për këto pasuri, të regjistruara në emër të qytetarit z. Q. L.

Në këto kushte në zbatim të ligjit nr. 111, datë 20.12.2018 "Për kadastrën" neni 26 është kërkuar relacion shpjegues se si është përfituar tokë bujqësore nga kryefamiljari z. Q. L, si dhe planrivelimet e hartuara për pasuritë e mësipërme.

Me shkresën nr. 1959/1, datë 27.8.2020 NJA Dajti është drejtuar ASHK Tirana rurale 1 për kthim përgjigje të shkresës nr. 5451, datë 28.7.2020 prot nja Dajt nr. 1959, datë 29.7.2020, në të cilën sqarohet se:

Sipas aplikimit nr. 17205, datë 21.7.2020 që qytetari z. Q. L ka bërë pranë ASHK.

Referuar formularit nr. 6, komisioni ndarjes së tokës bujqësore në fshatin Surrel e ka trajtuar këtë familje me sipërfaqe 6100 m², ku sipas certifikatës së gjendjes familjare ka në përbërje 5 (pesë) persona, si banorë fshatit Surrel

Sipas të dhënave të formularit 6 kjo familje është trajtuar në emër të bashkëshortes B. L, ndërsa akti është lëshuar në emër të z. Q. L. Ku norma për fryrë është 1400 m², sipas ligjit 7501.

Sipas certifikatës së pronësisë lëshuar nga ish- ZVRPP Tiranë, kjo familje është çertifikuar një pasuri me sipërfaqe 6500 m², kjo sipas kriterëve të nenit 24 të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" i ndryshuar dhe Vendimit nr. 255, datë 2.8.1991 pika 5 dhe 6, mbi koeficientet e përlllogaritjes së tokës bujqësore të konfirmuar nga planrivelimi i hartuar nga studio "B..." me topograf GJ. B. datë 26.8.2020, referuar gjendjes faktike në terren.

Konkluzioni: Përfituesi i AMTP-së nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore, bazuar në certifikatën e gjendjes familjare të administruar në dosje rezulton se familja bujqësore është banor i fshatit Surrel mbas datës 18.4.1996. Pajisja me AMTP nga komisioni i ndarjes së tokës të fshatit Surrel, është në kundërshtim me ligjin nr.7501 datë 19.07.1991 "Për tokën" i ndryshuar dhe me Vendimin nr. 255 datë 02.08.1991 "Për Kriteret e Ndarjes së Tokës Bujqësore" i ndryshuar me VKM nr.296, datë 07.07.1992.

4- Praktika e qytetarit P. M

Me shkresën nr. 1852/2, datë 9.4.2020 ASHK Tirana Rurale 1, ka kërkuar nga NJA Dajt që në mbështetje të aplikimit nr. 5118 dhe nr. 5928, datë 6.3.2020 të bërë nga qytetari P. M regjistrimin e AMPT me nr. 41, datë 8.5.1996, konfirmim si më poshtë:

Pse AMTP është lëshuar në emër të z. P. M (dhëndër), kur kryefamiljar është z. I. S, si dhe konfirmim nëse në emër të personave të tjera ka AMT të tjera të lëshuara nga NJA Dajt.

Me shkresën nr. 886/1, datë 24.4.2020, NJA Dajt informon ASHK Tirana Rurale 1, se familja bujqësore me kryefamiljarë z. I. S nuk është trajtuar me AMTP NJA Dajt, por është pajisur me AMTP nr. 41 nga fshati Surrel në emër të z. P. M. Gjithashtu asnjë nga anëtarët e tjerë të familjes me datë 01.8.1991 nuk kanë përfituar tokë bujqësore.

Sipas të dhënave AMTP është plotësuar gabim, pasi kjo familje bujqësore me datë 01.8.1991 nuk është familje bujqësore e NJA Dajt, por është e NJA Dajt, konfirmuar kjo nga certifikata e lëshuar me datë 8.3.2016.

Konkluzioni: AMTP-në me nr. 41, datë 8.5.1996, i plotësuar nga ish-komisioni i ndarjes së tokës, Fshati Surrel, në emër të z. P. M është i pavlefshëm, ku pavlefshmëria ka ardhur si shkak i shkeljes së ligjit nr.7501 datë 19.07.1991 "Për tokën" i ndryshuar dhe i VKM nr. 230, datë 22.7.1991, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e komisioneve të tokave", të ndryshuar dhe në udhëzimin nr.2, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave "Për funksionimin e komisioneve të tokës në rrethe e fshatra".

5- Praktika e qytetarit A. Ç

Me shkresën nr. 1521/, datë 5.2.2021 NJA Dajti është drejtuar z. E. B me funksion Drejtori Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), për dërgim dokumentacion për regjistrim fillestar të pasurisë të fituar me ligjin nr. 7501.

Me kërkesë nr. 152, datë 18.01.2021, qytetari z. A. Ç nga fshati Murth, ZK 2748, NJA Dajt është kërkuar plotësimi dokumentacionit për regjistrimin e AMTP nr. 44, datë 16.7.1991, së përfutur sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” i ndryshuar.

Sipas kërkesës qytetari kërkon të pajiset me certifikatë pronësie si vijon:

a- Për ngastrën me emërtimin popullor “Kopshti”, rreshti i parë në AMTP për sipërfaqen 1310 m² e llojit “arë”, sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 30.9.2020. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 104 me sipërfaqe 1310 m² në ZK 2748 fshati Murth.

b- Për ngastrën me emërtimin popullor “Ullinja”, rreshti i dytë në AMTP për sipërfaqen 2500 m² e llojit “arë”, sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 30.9.2020. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 236 me sipërfaqe 2500 m² në ZK 2748 fshati Murth.

c- Për ngastrën me emërtimin popullor “Shtogth mbi Kacoll”, rreshti i tretë në AMTP për sipërfaqen 4450 m², sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 30.9.2020. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 325 me sipërfaqe 4450 m² në ZK 2748 fshati Murth.

d- Për ngastrën me emërtimin popullor “Shtogth mbi Kacoll”, rreshti i katër në AMTP për sipërfaqen 1610 m², sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 30.9.2020. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 322 me sipërfaqe 1610 m² në ZK 2748 fshati Murth.

e- Për ngastrën me emërtimin popullor “BaShtogthiposhëm”, rreshti i pestë në AMTP për sipërfaqen 2000 m² e llojit “arë”, sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 30.9.2020. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 324 me sipërfaqe 2000 m², nga e cila 1817 m² e llojit “arë” dhe 138 m² e llojit “pyll” në ZK 2748 fshati Murth.

f- - Për ngastrën me emërtimin popullor “Geshtenjëza”, rreshti i gjashtë në AMTP për sipërfaqen 2140 m² e llojit “arë”, sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 30.9.2020. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 87 me sipërfaqe 2140 m² në ZK 2748 fshati Murth.

g- - Për ngastrën me emërtimin popullor “Liqenesh”, rreshti i parë në AMTP për sipërfaqen 2650 m² e llojit “arë”, sipas gjetjes faktike në terren, e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga topografi B. R me datë 30.9.2020. Kjo pasuri rakordon me pasurinë nr. 268 me sipërfaqe 1740 m² dhe me pasurinë 506 e sipërfaqe 257 m² dhe pasurinë 270 me sipërfaqe 653, në ZK 2748 fshati Murth.

Sipas informacionit kadastral pasurie 506 është e llojit “pyll”, për të cilën familja bujqësore do interesohet për regjistrim në një periudhë të dytë, referuar ligjit 20/2020.

Konkluzioni: Referuar të dhënave të mësipërme, evidentohet fakti se sipërfaqja e kërkuar për regjistrim është me e madhe se sipërfaqja që familja bujqësore që i takon në zbatim të ligjit 7501 për normën për fryme. Kështu sipas certifikatës së gjendjen familjare 01.8.1991, kjo familje është e përbërë nga 7 anëtarë. Norma për fryme në fshatin Murth është 2000 m²/frymë, e cila korrespondon një sipërfaqe prej 14000 m². Në fakt familja ka kërkuar për regjistrim një sipërfaqe prej 16660 m², ose më shumë për sipërfaqen 2660 m².

6- Praktika për regjistrim e qytetarit z. L. M

Me shkresën nr. 1650/1, datë 27.7.2020, NJA Dajt ka përcjellë në Drejtorinë e Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile Bashkia Tiranë, dokumentacionin për regjistrimin e pronës në emër të qytetarit z. S. M, konkretisht:

Ngastra me emërtimin popullorë “Kopshti i Myrtes”, rreshti i katër të AMTP nr. 207, datë 12.6.1991, të lëshuar nga komisioni i ndarjes së tokës së fshatit Priskë e Madhe, për sipërfaqen

3000 m². Kjo pasuri sipas planrivelimit të hartuar nga top z. B. R datë 18.6.2020, korrespondon me pasurinë 322/2 me sip 3000 m² të ZK 3051.

Certifikata familjare datë 01.8.1991 është me 4 anëtarë, ku kryefamiljari ka ndëruar jetë datë 15.12.2009, po kështu dhe bashkëshortja datë 6.3.2005. i biri z. N. M është ndarë dt. 13.12.2000, ndërsa z. L. M ndarë me dt. 15.10.2007.

Me shkresën nr. 25342/1, datë 7.8.2020 Drejtorinë e Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile Bashkia Tiranë, ka kërkuar NJA Dajt sqarim në lidhje me këtë pasuri, duke argumentuar se:

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, AMTP bashkëlidhur nr. 207, datë 12.6.1992 është pa vullë, siç përcaktohet në pikën 1 shkronjë (dh) e VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve”, i ndryshuar.

Gjithashtu AMTP është e pashoqëruar me shkresë nga ASHK, ku të informojë se AMTP është në gjendje e origjinalit në arkiv, si dhe ndodhet ose jo vula në AMTP.

Pasuria me nr. 322/2, sipas hartës 1/5000 me zë kadastral “TRUALL”, ndërsa sipas hartës me zë kadastral “pyll”. Në të dy rastet është zë kadastral i paregjistrushëm, sipas legjislacionit.

Me shkresën nr. 2103/1, datë 28.01.2020 NJA Dajt ka ridërguar dokumentacionin në përgjigje të shkresës nr. 25342/1, datë 7.8.2020 të Drejtorinë e Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile Bashkia Tiranë, mbi dokumentacionin e qytetarit z. S. M, duke informuar se:

Me kërkesë nr. 26950, qytetari Vladimir Myrta ka aplikuar pranë Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Rurale 1, për njësimin e AMTP te origjinalin në emër të z. S. M. Nga verifikimi në sistemin dixhital IPS, ky institucioni ka vënë në dispozicion AMTP në ZK 3051, fshati Priskë e Madhe në emër të z. S. M.

Familja kërkon të pajiset me certifikatë pronësi për rreshtin e katërt të AMTP me emërtimin popullorë “Kopshti i Myrtës” me sipërfaqe 3000 m² e llojit “arë” me kufizime Ceri-Shpia, Lindje-RrapushMyrta, Jug-Rrug dhe Perendim-B. M.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit kadastral nga NJA Dajt, referuar fragmentit të hartës 1/5000 dhe librit të tokës fshati Prikë e Madhe, ZK 3501 kjo sipërfaqe toke ndodhet brenda ngastrës me pasurinë 322 me ZK “truall” me sipërfaqe 20700 m².

Nga verifikimi në terren të gjendjes faktike, kjo parcela ka qenë tokë bujqësore, dhe si e tillë është trajtuar nga komisioni i ndarjes së tokës bujqësore fshati Priskë e Madhe, sipas normës për fryme 1750 m².

Referuar faktit se hartat 1/5000 janë shumë të vjetra nuk është bërë pasqyrimi i kësaj pasurie, duke ju referuar faktit.

Pra sipas NJA Dajt ka mospërputhje me midis dokumentacioni kadastral me AMTP me nr. 207. Referuar faktit kërkojmë vijimin e procedurës për pajisjen me dokumentacion pronësie për pasurinë 322/2, në emër të familjes bujqësore të z. S. M.

Konstatim: Nga ana e specialistit të ZAMIT-së Njësia Administrative Dajt nuk është verifikuar në librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991, për ngastrën me pasurinë nr. 322 me zë kadastral “truall” me sipërfaqe 20700 m².

7- Praktika për regjistrim e qytetarit z. XH. H

Me shkresën nr. 514/1, datë 13.5.2020, NJA Dajt i përcjellë Drejtorisë e Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile Bashkia Tiranë, dokumentacionin për regjistrim të qytetarit z. XH. H, në përgjigje të shkresës suaj nr. 322/3, datë 3.2.2020 prot njësia nr. 514, datë 8.2.2020.

Sipas shkresës nr. 322/3, datë 3.2.2020 përgjatë korrespondencës për dërgimin e AKTP nr. 141, dt. 13.6.1992 në emër të z. M. H dhe XH. H për regjistrim në ASHK, kërkohet që planet e rilevimit janë në emër të z. M. H për të cilën është lëshuar dëshmi trashëgiminë në emër të z. XH. H, si rrjedhim planet e rilevimit duhet të jenë në emër të z. XH. H.

Kërkohet regjistrimi i pasurisë sipas AMTP nr. 141, datë 8.2.2020 në emër të z. M. H, sipas vendimit për lëshim trashëgiminë nga noteri Rezarta B. Koci me nr. 2453rep, nr. 868 kol.

Vendim lëshim trashëgiminë nr. 2455rep,nr. 870 kol dhe deklaratës noteriale nr. 2454rep, nr. 870 kol.

a- Ngastra me emërimin popullorë “ara e gjatës”, rreshti i parë i AMTP me sipërfaqe 1000 m², sipas planrilevimit të hartuar nga top B. R me datë 21.3.2019 e cila rakordon me pasurinë nr. 358, ZK 3051 e llojit “ARË”, e sipërfaqe 1000 m², fshati Priskë e Madhe.

b- Ngastra me emërimin popullorë “fusha e mullinit”, rreshti i dytë i AMTP me sipërfaqe 1000 m², sipas planrilevimit të hartuar nga top B. R me datë 21.3.2019 e cila rakordon me pasurinë nr. 357, ZK 3051 e llojit “ARË”, e sipërfaqe 1000 m², fshati Priskë e Madhe.

c- Ngastra me emërimin popullorë “katruk”, rreshti i tretë i AMTP me sipërfaqe 500 m², sipas planrilevimit të hartuar nga top B. R me datë 12.12.2018 e cila rakordon me pasurinë nr. 273, ZK 3051 e llojit “ARË”, e sipërfaqe 500 m², fshati Priskë e Madhe.

d- Ngastra me emërimin popullorë “rravzhaq”, rreshti i katërt i AMTP me sipërfaqe 7200 m², sipas planrilevimit të hartuar nga top B. R me datë 21.3.2019 e cila rakordon me pasurinë nr. 400/2, ZK 3051 e llojit “ARË”, e sipërfaqe 7200 m², fshati Priskë e Madhe.

e- Ngastra me emërimin popullorë “gryka e rravzhaq”, rreshti i pestë i AMTP me sipërfaqe 2000 m², sipas planrilevimit të hartuar nga top B. R me datë 21.3.2019 e cila rakordon me pasurinë nr. 378/2, ZK 3051 e llojit “ARË”, e sipërfaqe 2000 m², fshati Priskë e Madhe.

Me shkresën nr. 3221/5, datë 20.5.2020 Drejtoria e Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile Bashkia Tiranë në përgjigje të shkresës nr. 514/1, datë 13.5.2020 (prot Bashkia Tiranë nr. 322/4, datë 14.5.2020), të NJA Dajt për dërgim për regjistrim të AMTP nr. 141 datë 13.6.1992 në emër të z. M. H, i formon se:

Pas depozitimit të certifikatës familjare të gjendjes me 01.8.1991 të z. M. H, ka tejkallim të normës për fryme. Nisur nga fakti se ligji nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar ka mbaruar së funksionuar me datë 31.12.2019, NJA Dajt duhet të informojë dhe konfirmojë normën për, fryme për të argumentuar sipërfaqen sipas AMTP.

Të konfirmohet nëse në emër të z. XH. H është lëshuar ose jo AMTP.

Me shkresën nr. 1118/1, datë 12.10.2020 NJA Dajt ridërgoi dokumentacioni në adresë të Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile Bashkia Tiranë, në përgjigje të shkresës nr. 3221/5, datë 20.5.2020 (prot njësi nr. 1118, datë 22.5.2020), duke rikonfirmuar se:

Të dyja familjet bujqësore janë trajtuar nga komisioni i ndarjes së tokës (këtu e vijim KNT) fshati Priskë e Madhe, vetëm me një AMTP nr. 141, datë 13.6.1992, ZK 3051 në emër të z. M. H. Në emër të z. XH. H nuk është lëshuar AMTP.

Sipas certifikatës së gjendjes familjare datë 01.8.1991, familja M. H përbëhet nga dy anëtarë.

Sipas certifikatës familjare 01.8.1991 familja XH. H përbëhet nga 4 anëtarë. Në total sipas AMTP nr. 141, janë trajtuar me tokë bujqësore gjashtë anëtarë të familjes, duke plotësuar në emër të dy familjeve bujqësore vetëm një AMTP.

Sipas dy certifikatave të gjendjes familjare familja bujqësore duhet të ishte trajtuar me tokë bujqësore me sipërfaqe 10500 m², ku në fakt është trajtuar me 11700 m² tokë bujqësore dhe 24 rrënjë ullinj, kjo në referencë të VKM nr. 255, datë 2.8.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore” pika 5 dhe 6.

Konkluzioni: Referuar të dhënave të mësipërme, evidentohet fakti se sipërfaqja e kërkuar për regjistrim është me e madhe se sipërfaqja që familja bujqësore që i takon në zbatim të ligjit 7501 për normën për fryme. Kështu sipas certifikatës së gjendjes familjare 01.8.1991, kjo familje është e përbërë nga 6 anëtarë. Norma për fryme në fshatin Priskë e Madhe është 1750 m²/frymë, e cila korrespondon një sipërfaqe prej 10500 m². Në fakt familja ka kërkuar për regjistrim një sipërfaqe prej 11700 m², plus 24 rrënjë ullinj ose më shumë në total një sipërfaqe prej 4080 m².

8- Praktika për regjistrim e qytetarit z. Q. M

Me shkresën nr. 2830/1, datë 15.10.2020 NJA Dajt i ka përcjellë Drejtorisë së Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile Bashkia Tiranë dokumentacionin për regjistrim në emër të qytetarit z. Q. M, sipas kërkesës së këtij të fundit datë 14.10.2020 (prot njësi nr. 2830) ZK 3550, sipas AMTP të lëshuar në zbatim të ligjit nr. 7501, lëshuar nga KNT fshati Tujan, respektivisht:

a- Ngastra me emërimin popullorë “Rrape”, rreshti i parë i AMTP me sipërfaqe 3700 m² e llojit “arë”, sipas planrilevimit të hartuar nga top E. H me datë 22.7.2020 e cila rakordon me pasurinë nr. 600/5, ZK 3426 me sipërfaqe 3140 m², fshati Tujan.

b- Ngastra me emërimin popullorë “Rrape”, rreshti i dytë i AMTP me sipërfaqe 4160 m² e llojit “arë”, sipas planrilevimit të hartuar nga top E. H me datë 22.7.2020 e cila rakordon me pasurinë nr. 598/7, ZK 3426 me sipërfaqe 4160 m², fshati Tujan.

Konstatimi: Nga të dhënat konstatohet se sipërfaqja e ndarjes së tokës për normë për frymë nuk është në përputhje me ligji nr. 7501, pasi sipas certifikatës së gjendjes familjare datë 01.8.1991 familja ka në përbërje 3 (tre) anëtarë nisur nga norma për frymë në fshatin Tujan (1140), kësaj familje i lejohet për certifikim një sipërfaqe prej 3420 m². Në fakt kjo ka kërkuar për regjistrim një sipërfaqe prej 7300 m², pra më shumë prej 3800 m².

9- Praktika për regjistrim e qytetarit z. H. T

Me shkresën nr. 2500/1, datë 23.9.2020 adresuar Drejtorit të Drejtorisë së përgjithshme të Objekteve në bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), NJA Dajt informon se pranë institucionit tonë është paraqitur kërkesa e qytetarit z. A. T me nr. 2500, datë 17.9.2020, banorë i fshatit Surrel. ZK 350, i cili kërkon plotësimin e dokumentacionit për regjistrimin e pasurisë të fituar me ligjin nr. 7501, në emër z. H. T, kjo sipas AMTP nr. 49 (fotokopje e njëzuar me origjinalin e dalë nga ASHK Rirana Rurale-1), konkretisht:

a- Ngastrën me emërtimin popullor “Kopshti”, sipas rreshtit të parë të AMTP, ku sipas gjendjes faktit në terren e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga studio “B...”, datë 23.9.2020 me nr. Pasuri 66 dhe sipërfaqe 1300 m² “arë”, fshati Surrel në ZK 3550.

b- Ngastrën me emërtimin popullor “Ullinj”, sipas rreshtit të dytë të AMTP, ku sipas gjendjes faktike në terren e konfirmuar sipas planrivelimit të hartuar nga studio “B...”, datë 23.9.2020 me nr. Pasuri 60 dhe sipërfaqe 1830 m² “ullishte”, fshati Surrel në ZK 3550. Brenda kësaj sipërfaqe ndodhen dhe 19 rrënjë ullinj, e cila dërgohet për regjistri referuar vendimit nr. 255, datë 2.8.191 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore, pika 8 m shkronjë (a,b)”.

Sipas të dhënave të NJA Dajt informon se familja bujqësore me kryefamiljarë z. H. T ka qenë banor i fshatit Surrel ish- Komua Dajt para vitit 1991 me banesë nr. 66/1. Kjo tregon se kjo familje bujqësore ka qenë anëtarë e ish-kooperativës bujqësore Pris, katundi Surrel, duke përfituar tokë me AMTP nr. 46 akti, sipas vendimit nr. 306, datë 30.6.1994

Por sipas të dhënave të gjendjes civile me datë 01.8.1991, kjo familje nuk ka qenë regjistruar në këtë njësi vendor por ka qenë e regjistruar në zyrën e gjendjes civile Bushtric Kukës me 10 anëtarë. Leja e banimit të NJA Dajt tregon se është transferuar me datë 28.12.1994. gjithashtu evidentohet fakti se AMTP nr. 46 është plotësuar sipas vendimit nr. 306. Datë 30.6.1994.

Referuar vërtetimit nr. 102, datë 21.9.2020, NJA Bushtric, Kukës, vërteton se familja me kryefamiljarë z. H. T nuk është trajtuar me tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501.

Konkluzioni: Përfituesi i AMTP-së nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore, bazuar në certifikatën e gjendjes familjare të administruar në dosje rezulton se familja bujqësore nuk është banor i fshatit Surrel. Pajisja me AMTP nga komisioni i ndarjes së tokës të fshatit Surrel është në kundërshtim me ligjin nr.7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar dhe me Vendimin nr. 255 datë 02.08.1991 “Për Kriteret e Ndarjes së Tokës Bujqësore” i ndryshuar me VKM nr.296, datë 07.07.1992.

AMTP-në me nr. 49, datë 30.6.1994, i plotësuar në emër të Z. H. T nga ish-komisioni i ndarjes së tokës, Fshati Surrel, është i pavlefshëm, ku pavlefshmëria ka ardhur si shkak i shkeljes së ligjit nr.7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar dhe i VKM nr. 230, datë 22.7.1991, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e komisioneve të tokave”, të ndryshuar dhe në udhëzimin nr.2, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin e komisioneve të tokës në rrethe e fshatra”.

10- Praktika për regjistrim e qytetarit z. I. V

Me shkresën nr. 4601, datë 7.2.2019, ZVRPP Tiranë është kërkuar nga NJA Dajt (fshati Lanabregas) që referuar aplikimit nr. 8530, datë 29.01.2019 të qytetarit I. V, i cili kërkon të pajiset me kartelë pasurie dhe hartë tregtuese për ZK 2380, pas 94/5, vol 1 fq 39 me sipërfaqe 1740 m².

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes që disponohet në ZVRPP, z. I. V është pajisur me certifikatë pronësi për sip 40 m² më shumë se AMTP nr. 12, rreshti i parë me emërtimin popullorë “abazet” (1700 m²).

Gjithashtu sipas dokumentacioni z. I. V ka përfituar 3 AMTP të shpërndara nga KT fshati Lanabregas me sipërfaqe:

1. AMTP datë 10.6.1992 me sip = 4500 m².
2. AMTP datë 25.6.1992 me sip = 3550 m².
3. AMTP (dublikatë) datë 5.7.1993 me sip = 1720 m² me emërtime popullorë të ndryshme.

Nga ZVRPP është kërkuar NJA Dajt ligjshmërinë e këtyre AMTP-ve dhe sipërfaqja e përfituar më shumë.

Me shkresën nr. 442/1, datë 15.2.2019, NJA Dajt në përgjigje të shkresës nr. 4601, datë 7.2.2019 të ZVRPP (prot NJA Dajt nr. 442, datë 8.2.2019), sqaron se:

Për fshatin Lanabregas norma për fryme është 1400 m². Gjithashtu sipërfaqja e pronave sipas AMTP-ve datë 5.7.1993 dhe datë 10.6.1992, janë sipas formularit 6 që disponohet në njësi.

Në lidhje me AMTP datë 25.6.1992, në NJA Dajt nuk ka asnjë dokument me anë të së cilës të vërtetoje saktësinë e sajë, pasi nuk rezulton e regjistruar në formularin 6.

Konkluzioni: AMT datë 10.6.1992 me sipërfaqe 4500 m² ka një sipërfaqe më shumë se sa i takon norma për fryme, kjo sipas certifikatës 01.8.1991. Kështu sipas certifikatës, familja për përbehet prej 3 anëtarë e cila i korrespondon një sipërfaqe pre 4200 m² (3 * 1400 m²), pra më shumë për sipërfaqen 300 m².

11- Praktika për regjistrim e qytetarit z. S. L

Me shkresën nr. 34942/1, datë 19.12.2018 ZVRPP i kërkon NJA Dajt konfirmim dokumentacioni, si vijon:

Në ZVRPP Tiranë me aplikim nr. 117889, datë 3.12.2019 bërë nga Slime Liçi si përfaqësues me prokurë S. L (trashëgimtar testament), në të cilën kërkohet vijimi i procedurës për dokument pronësie.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në arkivën e ZVRPP Tiranë është depozituar AMTP-ja nr. 36, datë 01.7.1992 në emër të z. S. L me sip = 3450 m² me pasuri nr. 150/2, vol 2, fq 36 zk. 2460 Fshati Linzë, në këtë gjendje ref aktit 1700 m², ref ln 1960 m² “pemëtores”, sipas rreshtit parë me emërtimin popullor “kopshti kodër” në AMTP me sip = 1700 m².

AMTP e përcjellë për regjistrim datë 25.5.1996 ne emër z. S. L me sip totale 6300 m², mungon nr. Akti, firma kryetarit të komisionit të tokës së fshatit.

Të dhënat e aktit nuk përputhen me të dhënat e aktit të depozituar në arshivën e ZVRPP.

Nga NJA nuk është sqaruar fakti se mbi bazë ligjore është plotësuar AMTP-ja e datës 25.5.1996, pasi në certifikatën familjare 01.8.1991, kryefamiljarë është znj. XH. L dhe subjekti i trajtuar në AMTP është S. L. Nisur nga fakti se XH. L ka ndëruar jetë me datë 8.9.2001, duhet të ishte depozituar dëshmia e trashëgimisë.

Kërkohet të regjistrohet sip = 4300 m² me emërtimin popullor “kopshti kodër” në AMTP m sip = 4300 m² “pemtores”. Plan rilevimi i përcjellë për regjistrim si konfiguracion është i njëjtë me regjistrimin fillestar, konfirmuar në H.T.R të ZVRPP me nomenklaturë K-34-101-(237-C), mbi pasurinë 145/1, pasuri e regjistruar në vol 2, fq 177, zk 2460, fshati Linzë.

Kërkohet të regjistrohet sip = 2000 m² me emërtimin popullor “kopshti çelikut” në AMTP me sip 2000 m² “pemtores”. Planrivelimi i përcjellë për regjistrim si konfiguracion është i njëjtë me regjistrimin fillestar, konfirmuar në h.t.r të ZVRPP me nomenklaturë K-34-101-(237-C), mbi pasurinë 150/2, pasuri e regjistruar në vol 2, fq 177, zk 2460, fshati Linzë.

Nisur nga fakti se ka mospërputhje të sip të regjistrimit fillestar me sip që sillet për regjistrim, bazuar në VKM nr. 994, datë 9.12.2015, nga NJA Dajt kërkohet të dërgohet zyrtarisht relacioni shpjegues.

Me shkresën nr. 4294/1, datë 21.3.2019 NJA Dajt informon ZVRPP në vijim të kërkesës paraqitur me shkresën nr. 34942/1, datë 19.12.2018 (prot njësi nr. 4294, datë 20.12.2018), duke informuar se:

Lidhur me ekzistencën e dy AMTP-ve, nga dokumentacioni i ndarjes së tokës fshati Linzë, referuar formularit 6 është plotësuar AMTP nr. 36, datë 01.7.1992, me sip = 3450 m² dhe 25 njënjë ullinj.

Ndërsa AMTP e datë 25.5.1996 me sip = 6300 m² përfshihet dhe ngastrën e shënuar në AMT nr. 36 datë 01.7.1992. Firma e Kryetarit të komisionit të ndarjes së tokës (e munguar) justifikohet me vulën në formatin e AMTP-së. Në lidhje me plotësimin e AMTP në emër të z. S. L, kur kryefamiljarë ka qenë znj. XH. L nuk kemi informacion, pasi kështu është gjykuar nga KNT.

Konstatimi: Nga NJA nuk është sqaruar fakti se mbi çfarë reference ligjore është plotësuar AMTP-ja e datës 25.5.1996, pasi në certifikatën familjare 01.8.1991, kryefamiljarë është znj. XH. L dhe subjekti i trajtuar në AMTP është S. L. Mungon në dosje dëshmia e trashëgimisë për trashëgimlënësin XH. L.

12- Praktika për regjistrim e qytetarit z. A. F.

Me shkresën nr. 2407/1, datë 26.9.2019 NJA Dajt informon Bashkinë Tiranë mbi kërkesën nr. 2407, datë 26.09.2019 të qytetarit z. A. F nga fshati Priskë e Madhe zk. 3051 për regjistrimin e pasurisë sipas AMTP nr. 4, datë 25.6.1996, respektivisht:

a- Ngastrën me emërtimin popullorë “bajet” rreshti parë në AMTP me sip = 6200 m², e llojit arë, sipas planrivelimit të hartuar nga top B. R datë 2.08.2019 me pasuri 5/3, zk. 3051.

b- Ngastrën me emërtimin popullorë “manate” rreshti dytë në AMTP me sip = 2000 m², e llojit arë, sipas planrivelimit të hartuar nga top B. R datë 2.08.2019 me pasuri 10, zk. 3051.

c- Ngastra me emërtimin popullorë “kryedobes” rreshti tretë në AMTP me sip = 5000 m², e llojit arë, sipas planrivelimit të hartuar nga top B. R datë 2.08.2019 me pasuri 5/3, zk. 3051.

d- Ngastrën me emërtimin popullorë “ullinj” rreshti katër në AMTP me sip = 2000 m², sipas planrivelimit të hartuar nga top B. R datë 2.08.2019 me pasuri 5/3, zk. 3051

Konkluzioni: Referuar sipërfaqes së përgjithshme të kësaj AMTP-je norma për fryme nuk e lejon, pasi sipas certifikatës familjare duhet të kishte përfituar një sipërfaqe prej 8750 m², çfarë do të thotë se ka përfituar një sipërfaqe prej 4450 m² më shumë duke tejkaluar normën për frymë, në këto kushte AMTP-ja me nr. 4, datë 25.6.1996, është pjesërisht e pavlefshme.

Katër Plan rilevimet janë përgatitur dhe hartuar nga topografi i Njësisë Administrative Dajt Z. B. R dhe jo nga topografi i licënuar.

13- Praktika për regjistrim e qytetarit z. B. M

Me shkresën nr. 2907/1, datë 15.11.2019 nga ana e Njesisë Administrative Dajt është përcjell dokumentacioni DV ASHK-së Tirana Rurale 1, për vazhdimin e procedurës për korrigjimin e pozicionimit hartografik dhe i sipërfaqes për pasurinë nr.364/4.

Pasuria nr. 364/4 bazuar në statusin juridik të pronës të konfirmuar nga DV ASHK-së Tirana Rurale 1, rezulton se kjo sipërfaqe sipas LN është 2700 m².

Qytetari B. M për këtë pasuri është pajisur me certifikatë pronësie me sipërfaqe prej 2700 m² në datë 17.06.2003, sipërfaqe kjo më e madhe se ajo që është në AMTP, konkretisht me sipërfaqe 2400 m², në Z.K. 3051 Priskë e Madhe.

Në dosje janë administruar dy planrilevimi po nga i njëjti Topograf me licencë z. B. R, në planrilevimin e datës 07.04.2019 e miratuar nga Njësia Administrative Dajt, rezulton se është e saktësuar sipërfaqja nga 3144 m² në sipërfaqe 2400 m² me një diferencë prej 744 m² dhe tjetra plan-rilevimi i përgatitur po nga Topografi me licencë z. B. R që mban datën 08.07.2019 e miratuar nga Njësia Administrative Dajt, rezulton se është e saktësuar sipërfaqja nga 2700 m² në sipërfaqe 2400 m² me një diferencë prej 300 m², kjo referuar LN te ZVRPP dhe jo gjendjes faktike.

Konstatohet se plan-rilevimi e konfirmuar nga ana NJA Dajt shoqëruar edhe me relacion shpjegues ka pasaktësi në sipërfaqen e mbetur e cila pasqyrohet njëherë 300 m² dhe njëherë me sipërfaqe 744 m², çfarë tregon pasaktësi në matjet grafike që i është bërë parcelës nr.364/4 në hartën treguese.

Gjithashtu sipas dokumentacionit z. B. M është përfutues i dy AMTP-ve të ndryshme të shpërndara nga KT fshati Priskë e Madhe, përkatësisht: AMTP nr. 189, datë 11.6.1992 me sip = 11200 m² dhe AMTP nr. 232, datë 14.5.2003 me sip 3700 m² me emërtimin popullorë të ndryshëm.

Me shkresën nr. 441/1, datë 12.2.2019, NJA Dajt në përgjigje të shkresës nr. 4602, datë 7.2.2019 të ZVRPP Tiranë, informon se:

NJA Dajt nuk disponon AMTP origjinale të z. B. M. Norma për frymë në fshatin Priskë e Madhe është 1750 m². Sipërfaqja e tokave sipas AMTP datë 11.6.1992 rezulton e njëjtë me formularin 6 me sip = 11200 m².

Konkluzioni: Nga specialisti i ZAMIT-t të Njesisë Administrative Dajt nuk është verifikuar pasuria në terren por është referuar plan-rilevimin i përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit i është referuar pasurisë sipas hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1.

-Nga specialisti i ZAMIT-t të Njesisë Administrative Dajt, është pranuar planrilevimi Topografi me licencë z. B. R, duke copëzuar pasurinë nr. 364/4 në tre pasuri të tjera “shtet” krejtësisht të pashfrytëzueshëm duke marr një konfigurim krejtësisht të ndryshëm nga fragmenti i hartës kadastrale, në kundërshtim me nenin 36, pika "b", të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”. Sipas normës për frymë, sipërfaqja sipas AMTP është më e madhe për sip 2450 m² {11200 m² – 8750 m² (1750 m² x 5 anëtarë)}

14- Praktika “Përcjellje dhe verifikim dokumentacioni” për z. M. E.

Me shkresën nr. 550/1/1 prot., datë 19.02.2021 nga ana e Njesisë Administrative Dajt është përcjell dokumentacioni DV ASHK-së Tirana Rurale 1, në bazë të kërkesës së paraqitur nga Z. R. E me datë 19.02.2021 e protokolluar me nr.550, fshati Surrel, Z.K. 3550

Në shkresën e Njesisë Administrative Dajt që i drejtohet DV ASHK-së Tirana Rurale 1, është përcjellë për regjistrim AMTP-ja me nr. Akti 71, datë 20.06.1992, në emër të R. E

Nga verifikimi i AMTP-së nr. Akti 71, datë 20.06.1992 konstatohet se është përcjellë për regjistrim rreshti i katër i AMTP-së, i shtuar poshtë vijës mbyllëse 30 rrënjë ullinj.

Në shkresën përcjellëse është cituar se: “Në ngastrën në rreshtin e katër në AMTP janë shënuar 30 rrënjë “Ullinj”, sipas gjendjes faktike në terren konfirmuar edhe sipas plan rilevimin të hartuar nga topografi i Njesisë Administrative Dajt B. R me datë 15.02.2021 rakordon me

pasurinë nr.73, 76 me sipërfaqe 5960 m², barazvlefshme me 30 rrënjë ullinj në fshatin Surrel Z.K. 3550.

Shkresë janë bashkëlidhur, certifikata e gjendjes civile 1 gusht 1991, plan rievimi dhe kopje e AMTPs-së.

Bazuar në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile të Njesisë Administrative Dajt rezulton se familja bujqësore përbehet me 5 anëtarë.

Bazuar në AMTP-ja me nr. Akti 71, datë 20.06.1992, rezulton se në emër të R. E është plotësuar me tokë bujqësore në tre ngastra “arë” me sipërfaqe totale prej 6360 m² plus 30 rrënjë ullinj, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës fshati Surrel.

Norma për frymë në Fshatin Surrel ka qenë 1400 m² e barabartë me një sipërfaqe tokë prej 7000 m².

Plan rievimit i hartuar me datë 15.02.2021 nga topografi i Njesisë Administrative Dajt B. R me sipërfaqe 5960 m² është konfirmuar nga Përgjegjësi i ZMMT Z. R. M dhe i miratuar nga Kryetari i Njesisë Administrative Dajt

Nga auditimi rezulton se Njësia Administrative Dajt në vazhdimësi ka llogaritur si të ardhura nga tatimi për një rrënjë ullinj të barabartë me një sipërfaqe nga 80 m² deri 120 m² çfarë do të thotë se 30 rrënjë ullinj që posedon Z. M. E është e barabartë më (max.) 120 m² x 30 rrënjë ullinj = 3600 m², ndërsa kërkesën e Z. R. E e miraton me sipërfaqe 5960 m².

Konkluzion: Nga Njësia Administrative Dajt është pranuar kërkesa e Z. R. E për “Përcjellje dhe verifikim dokumentacioni” për në DV ASHK Rurale 1, për një sipërfaqe prej 2400 m² më shumë se sa është përcaktuar në Vendimin e KK duke tejkaluar normën për frymë, në kundërshtim me ligjin nr, 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe me ligjit 20/2020 dhe ligjin nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

Nga Njësia Administrative Dajt është pranuar kërkesa bazuar në një planet e rievimit të përgatitur dhe hartuar nga topografi i Njesisë Administrative Dajt z. B. R dhe jo nga topografi i licencuar, si dhe plan rievimi i përgatitur nuk përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”, në kundërshtim me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

15- Praktika “Përcjellje dhe verifikim dokumentacioni” për z. S. M.

Me shkresën nr. 3802/1 prot., datë 22.12.2020 nga ana e Njesisë Administrative Dajt është përcjell dokumentacioni DV ASHK-së Tirana Rurale 1, në bazë të kërkesës së paraqitur nga z. S. M me datë 21.12.2020 e protokolluar me nr.3802, fshati Surrel, Z.K. 3550

Në shkresën e Njesisë Administrative Dajt që i drejtohet DV ASHK-së Tirana Rurale 1, është përcjellë për regjistrim AMTP-ja me nr. Akti 14, datë 20.12.1994, në emër të S. M.

Nga verifikimi i AMTP-së nr. Akti 14, datë 20.12.1994 konstatojmë se është përcjellë për regjistrim ngastra me emërtimin popullor “ullishte”, rreshti i gjashtë i AMTP-së, 13 rrënjë ullinj, pa përcaktuar sipërfaqen, bazuar në plan rievimin e përgatitur nga Studio “B...” me datë 19.10.2020 ku pronësia e pretenduar është e pozicionuar në pasurinë nr.27 me sipërfaqe 1700 m² brenda kësaj sipërfaqe ndodhën 13 rrënjë ullinj, fshati Surrel Z.K. 3550.

Në shkresë drejtuar DV ASHK-së Tirana Rurale 1, citohet se “...referuar dokumentacionit kadastral, librit të tokës dhe hartës kadastrale të shk. 1:5000 të ish-kooperativës bujqësore Priskë e Madhe, katundi Surrel kjo pasuri e llojit ullishte është e pa pasqyruar. Komisioni i ndarjes së tokës bujqësore, duke ju referuar gjendjes faktike në terren e ka trajtuar këtë familje bujqësore me 13 rrënjë ullinj brenda ngastrës nr.27. Duke ju referuar faktit se dokumentacioni kadastral që disponojmë është shumë i vjetër nuk është bërë pasqyrimi i pasurisë në fjalë ku brenda së cilës ndodhën 13 rrënjë ullinj.

Konstatimet e bëra nga Njësia Administrative Dajt janë kontradiktorë për faktin se njëherë prononcohet se referuar dokumentacionit kadastral, kjo pasuri e llojit ullishte është e pa

pasqyruar dhe herën tjetër brenda të njëjtit shkresë pranon se dokumentacioni kadastral që disponojmë është shumë i vjetër nuk është bërë pasqyrimi i pasurisë në fjalë.

Nga verifikimi konstatohet se në emër të z. S. M janë lëshuar dy AMTP njëra me nr. 104, datë 10.06.1992 me sipërfaqe totale 4500 m² dhe tjetra AMTP me nr. 14, datë 20.12.1994 me sipërfaqe totale 6800 m² plus 13 rrënjë “ullinj”.

Sipërfaqe totale e dy AMTP-ve është 13000 m² së bashku me 13 rrënjë “ullinj”, bazuar në gjendjen familjare të 1 gushtit 1991, kjo familje përbëhet prej tre anëtarësh.

Nga Njësia Administrative Dajt është pranuar kërkesa për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës në emër të Z. S. M, bazuar në dy AMTP ku rezulton se familja bujqësore ka përfituar në total një sipërfaqe prej 13000 m² tokën bujqësore.

Në shkresën nr. 3802/1 prot., datë 22.12.2020, Njësia Administrative Dajt është referuar Vendimit të Këshillit të Komunës me nr.45, datë 17.10.03.2010, pika 2 gërma a. *Pika 2.2 të shtohet pika 2.2/a mbi sipërfaqen e tatushme për rrënjë “ullinj”*, por nuk ka përcaktuar se sa metër katrorë është vendosur tatimi për një rrënjë ullinj.

Nga auditimi dosjes në emër të z. S. M rezulton mungon korrespondenca midis Njesisë Administrative Dajt dhe Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes të Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Tiranë, për të kërkuar informacion në lidhje me ngastrës nr.27,Z.K. 3550, për sa kohë Njësia Administrative Dajt nuk ka informacion për dokumentacionin kadastral.

Mungon statusi juridik i pronës e konfirmuar nga DV ASHK Rurale 1, për pasurinë nr.27 me sipërfaqe 1700 m² për llojin e pasurisë (zërin kadastral), në çfarë volumi dhe faqe është regjistruar pasuria, si dhe në çfarë emëri është hapur kartela e pasurisë së paluajtshme.

Me shkresën nr. 960/1 prot., datë 28.01.2021 nga DV ASHK Tirana Rurale 1, i është drejtuar Njesisë Administrative Dajt për dijeni Z, S. M, ku citohet se “...në vijimi të shkresë nr. 3802/1 prot., datë 22.12.2020 nga ana e Njesisë Administrative Dajt është përcjell dokumentacioni DV ASHK-së Tirana Rurale 1, për regjistrim AMTP-ja me nr. Akti 14, datë 20.12.1994, në emër të S. M”. *Kjo pasuri vazhdon në shkresën “Kthim dokumentacioni” bazuar në plan rilevimin e përcjell nga ana juaja pozicionohet në pasurinë 27/4, vo; 5, faqe 218, Z.K.3550, në llojin e pasurisë “Pyll”, në pronësi “shtet”.*

Në bazë të VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, pika 1/c në mënyrë që zyra jonë të procedoje me regjistrimin e AMTP-ve, duhet që AMTP-ja të përmbajë element të formës dhe përmbajtjes, ku ndër të tjetra përfshihet edhe sipërfaqja, në rastin e rrënjëve të ullinjve mungojnë elementët e përmbajtjes së AMTP-së pasi nuk është e përcaktuar sipërfaqja.

Në bazë të nenit 7, pika c, të Ligjit nr.20/2020, datë 5.3.2020 “Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, për regjistrimin e AMTP duhet të plotësohen këto kritere; toka për të cilën është lëshuar AMTP-ja nuk ka qenë “truall”, “vepër e infrastrukturës publike”, “rërë bregdetare”, “plazh” ose “sipërfaqe ujore”, në kohen e lëshimit të aktit, ndodhur në këto kushte që “pylli” nuk është subjekt i ndarjes së tokës me ligjin nr, 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar dhe i regjistrimit sipas ligjit 20/2020 dhe i ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, ***Ju bëjmë me dije se nuk mund të vijojmë me procedurën e regjistrimit të ngastrës me emërtimin popullor “ullishte”, rreshti i gjashtë i AMTP 13 rrënjë “ullinj”.***

Konkluzion: Nga Njësia Administrative Dajt, është pranuar kërkesa e z. S. M për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa verifikuar më parë vlefshmërinë e ngastrës me emërtimin popullor “ullishte”, që bazuar në “kthim përgjigje të DV ASHK Tirana Rurale 1, rezulton në llojin e pasurisë tokë “Pyll”.

-Nga auditimi dosjes në emër të z. S. M rezulton mungon korrespondenca midis Njesisë Administrative Dajt dhe Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes të Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Tiranë, për të kërkuar informacion në lidhje me ngastrës nr.27,Z.K. 3550, për sa kohë Njësia Administrative Dajt nuk ka informacion për dokumentacionin kadastral.

-Mungon statusi juridik i pronës e konfirmuar nga DV ASHK Rurale 1, për pasurinë nr.27 me sipërfaqe 1700 m² për llojin e pasurisë (zërin kadastral), në çfarë volumi dhe faqe është regjistruar pasuria, si dhe në çfarë emëri është hapur kartela e pasurisë së paluajtshme.

16. Praktika për regjistrim e qytetarit z. Z. K (N. B).

Nga ASHK Tirana Rurale nr. 1, kthen përgjigje qytetarit B. B se sipas aplikimit nr. 18287, datë 21.4.2022 për regjistrim të dëshmisë së trashëgimisë dhe pajisjen me certifikatë pronësie AMTP nr. 53 në emër të znj. N. B, fshati Tufinë NJA Dajt, informon se bazuar në VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 “Për Procedurat e regjistrimit të AMTP, saktësimin e kufijve të sipërfaqeve si dhe norma shtesë për sipërfaqe shtetërore shtesë, ku sipas deklaratës noteriale shpreheni se nuk keni qenë punonjës të kooperativës bujqësore në NJA Dajt, gjë e cila bie ndesh me kreun II pika 6.1 të VKM nr. 1174, datë 24.12.2020.

Kërkohet informacion nga NJA Dajt nëse qytetarin është në kushtet e dispozitës së mësipërme.

Me shkresën nr. 2277/1, datë 15.7.2022 NJA Dajt informon ASHK Tiranë Rurale 1 se sipas kërkesës së bërë nga qytetari z. Z. K me prokurë të posaçme nr. 7359rep/2364kol, datë 5.10.2021, si përfaqësues ligjorë i trashëgimtarit N. B, informon se:

Sipas dokumentacionit të ndarjes së tokës fshati Tufinë (formulari 6), qytetari znj. N. B ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe 2450 m² si dhe 6 rrënjë ullinj.

Pavarësisht gjendjes civile e cila e ka pasur Zall-Bastar ajo fizikisht ka jetuar në fshatin Tufinë më të birin B. B i cili e ka pasur gjendjes civile NJA Dajt. Në këto kushte KNT fshati Tufinë e ka trajtuar me tokë bujqësore subjektin Naxhije Balliu sipas normës për frymë. Nga informacioni i marrë nga NJA Zall-Bastar qytetari Naxhije Balliu nuk është trajtuar me tokë bujqësore në NJA Zall Bastar.

Konkluzioni: Përfituesi i AMTP-së nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore, bazuar në certifikatën e gjendjes familjare të administruar në dosje rezulton se familja bujqësore nuk është banor i fshatit Tufinë por është banor i fshatit Zall-Bastarë.

Pajisja me AMTP nga komisioni i ndarjes së tokës të fshatit Tufinë është në kundërshtim me ligjin nr.7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar dhe me Vendimin nr. 255 datë 02.08.1991 “Për Kriteret e Ndarjes së Tokës Bujqësore” i ndryshuar me VKM nr.296, datë 07.07.1992.

AMTP-në me nr. 53, i plotësuar në emër të znj. N. B nga ish-komisioni i ndarjes së tokës, Fshati Tufinë, është i pavlefshëm, ku pavlefshmëria ka ardhur si shkak i shkeljes së ligjit nr.7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar dhe i VKM nr. 230, datë 22.7.1991, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e komisioneve të tokave”, të ndryshuar dhe në udhëzimin nr.2, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin e komisioneve të tokës në rrethe e fshatra”.

17. Praktika për regjistrim e qytetarit Z. H. D, rezultoi se:

Me shkresën nr. 552/1 prot., datë 19.02.2021 “Përcjellje dhe verifikim dokumentacioni” nga Njësia Administrative Dajt është përcjell dokumentacioni në Drejtoria Vendore ASHK Tirana Rurale 1, për Z. H. D.

Në shkresën e Njesisë Administrative Dajt që i drejtohet DV ASHK-së Rurale 1, citohet se:

Pranë institucionit tonë është paraqitur kërkesa e z. Hamid Deliu protokolluar me nr.552, prot., datë 9.02.2012, nga Fshati Linz, Z.K. 2460, Njësia Administrative Dajt, ku kërkon plotësimin e dokumentacionit për regjistrimin e pasurive të fituar me ligjin nr.7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar. Sipas AMTP-së në emër të z. H. D me nr. Akti 128, datë 08.04.2003 lëshuar nga komisioni i ndarjes së tokës Linz.

Kërkon të pajiset me certifikatë pronësie për:

1. Ngastar me emërtimin popullor “Linz” rreshti i gjashtë në AMTP, me sipërfaqe 4500 m² “Arë” sipas gjendjes faktike në terren, konfirmuar edhe sipas plan rilevimit të trajtuar nga topografi me licencë me datë përgatitje 01.10.2020, ku rakordon me numër pasurie 505, sipërfaqe 2250 m² dhe për diferencën prej 2250 m² familja bujqësore do të interesohet në një moment të dytë, Z.K. 2460, Fshati Linz.

Bashkëlidhur është dërguar:

1. *Certifikatë e gjendjes 01.08.1991*

2. *Planimetria*

3. *AMTP nr. Akti 128, datë 08.04.2003*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të z. H. D rezulton se:

Njësia Administrative Dajt ka pranuar kërkesën e z. H. D për dërgimin e AMTP-së për regjistrim pasurie, pa verifikuar më parë vlefshmërinë e ngastres me emërtimin popullor “Linz” rreshti i gjashtë në AMTP, me sipërfaqe 4500 m² në llojin e pasurisë “Arë”.

Nga auditimi i formularit nr.6, që është e administruar në arkivën e Njesisë Administrimit Dajt, rezulton së në emër të familjes bujqësore H. D është furnizuar me tokë bujqësore për 5 ngastra me sipërfaqe totale prej 5323 m² plus rrënjë ullinj (3300 m²).

Në formularin e AMTP-së me nr. Akti 128, i plotësuar me datë 08.04.2003, përveç 5 rreshtave me numër ngastrash dhe me emërtim popullor, janë shtuar edhe 2 (dy) rreshta pa nr, ngastre, njëra me sipërfaqe 4500 m² dhe tjetra me sipërfaqe 1270 m² si tokë “arë” (shtesa e bërë në AMTP është e dyshuar për falsifikim)

Nga ana e specialistit të ZAMIT-së Njësia Administrative Dajt rezulton të mos jetë verifikuar ngastra e shtuar në rreshtin nr.6 me sipërfaqe 4500 m² të AMTP-së, nëse ekziston në formularin nr.6, sipërfaqja prej 4500 m², çfarë do të thotë se shtesa e 2 (dy) rreshtave pa nr, ngastre, njëra me sipërfaqe 4500 m² dhe tjetra me sipërfaqe 1270 m² nuk përputhet me formularin nr.6, që posedohet nga Njësia Administrative Dajt.

Nga ana e specialistit të ZAMIT-së Njësia Administrative Dajt nuk është verifikuar në librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991, llojin e pasurisë për ngastrën me emërtimin popullor “Linz” nëse është “pyll” apo “arë”, për të vlerësuar vlefshmërinë e plotësimit të AMTP me nr. Akti 128, datë 08.04.2003 lëshuar nga ish-komisioni i ndarjes së tokës Linz.

Nga auditimi i bërë në librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991, për llojin e pasurisë për ngastrën me emërtimin popullor “Linz” rezultoi se pasuria “mëmë” me nr.505 është në zërin kadastral “pyll” dhe nuk është tokë bujqësore, çfarë do të thotë së nuk ka qenë objekt i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar.

Mungon statusi juridik i pronës të pretenduar nga Z. H. D e konfirmuar nga DV ASHK Rurale 1, për pasurinë nr.505 me sipërfaqe 4500 m² për llojin e pasurisë (zërin kadastral), në çfarë volumi dhe faqe është regjistruar pasuria, si dhe në çfarë emëri figuron e hapur kartela e pasurisë së paluajtshme.

Plan rilevimi datë 01.10.2020 i hartuar nga Studio “G...” sh.p.k. me licensën nr.NZ.7254/3. datë 18/03/2019, nuk është miratuar nga Përgjegjësi i ZMMT-së R. M, por vetëm nga Kryeplaku i Fshatit Linz Defrim Bastari dhe nga Kryetari Njesisë Administrative Dajt K. Q.

Mungon relacioni shpjegues drejtuar Drejtoria Vendore ASHK Tirana Rurale 1, në lidhje me kërkesën për regjistrim të pasurisë nr. 505 me sipërfaqe 2250 m² sipas ngastrës me emërtimin popullor “Linz” rreshti i gjashtë në AMTP, me sipërfaqe 4500 m² “Arë”.

Për sa më sipër shtesa e dy 2 (dy) rreshtave pa nr, ngastre, njëra me sipërfaqe 4500 m² dhe tjetra me sipërfaqe 1270 m² si tokë “arë” në AMTP-në me nr. Akti 128, datë 08.04.2003, në emër të Z. H. D është relativisht i pavlefshëm, ku pavlefshmëria ka ardhur si shkak i shkeljes së ligjit nr.7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar dhe i VKM nr. 230, datë 22.7.1991, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e komisioneve të tokave”, të ndryshuar dhe në udhëzimin nr.2, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin e komisioneve të tokës në rrethe e fshatra”, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës, Fshati Linz.

“Akti i marrjes së tokës në pronësi” është i vlefshëm vetëm kur ai është krijuar sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 255 datë 02.08.1991 “Për Kriteret e Ndarjes së Tokës Bujqësore” i ndryshuar me VKM nr.296, datë 07.07.1992.

Kanë vlefshmëri ligjore titujt e pronësisë private mbi tokën, të krijuar te:

a) sipërfaqet, që më 1.8.1991 kanë figuruar në regjistrat kadastrale, në zërin “Tokë bujqësore” dhe janë përfshirë në territoret e administruara nga ish-kooperativat bujqësore deri në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar;

Në bazë të të nenit 7, pika c, të Ligjit nr.20/2020, datë 5.3.2020 “Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, për regjistrimin e AMTP duhet të plotësohen këto kritere; toka për të cilën është lëshuar AMTP-ja nuk ka qenë “truall”, “vepër e infrastrukturës publike”, “rërë bregdetare”, “plazh” ose “sipërfaqe ujore”, në kohën e lëshimit të aktit, ndodhur në këto kushte që “pylli” nuk është subjekt i ndarjes së tokës me ligjin nr, 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar dhe i regjistrimit sipas ligjit 20/2020 dhe i ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

Në këto kushte, pranimi i kërkesës të Z. H. D, miratimi i plan rilevimit për pasurinë nr.505 me sipërfaqe 2250 m² në llojin e pasurisë “Pyll” dhe dërgimi i AMTP-së për regjistrim, pa verifikuar më parë formularin nr.6, librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991 për vlefshmërinë e ngastrës për zërin kadastral të pasurisë me nr. 505, në bazë të nenit 109, të Ligjit nr. 44/2015 “Për Kodin e Procedurës Administrative” është një akt administrativ i paligjshëm, ku paligjshmëria është rezultat i miratimit të aktit (plan rilevimit) në kundërshtim me ligjin material.

Spektori i regjistrimit pranë Drejtoria Vendore ASHK Tirana Rurale 1, bazuar në dokumentacionin e dërguar me shkresën nr. 552/1, datë 19.02.2021 nga Njësia Administrative Dajt, ka bërë të mundur regjistrimin e pasurisë në emër të Z. H. D me nr. Pasurie 505/361, në vol.64, faqe 11, Z.K. 2460 nga lloji i pasurisë “pyll” në llojin e pasurisë “arë” më sipërfaqe 2250 m², Fshati Linz, ky dokument regjistrimi ka marre numërin e referencës 000020863.

Nga Njësia Administrative Dajt, është pranuar kërkesa e z. H. D për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, pa verifikuar formularin nr.6, nëse ngastra me emërtimin popullor “Linz” rreshti i gjashtë dhe shtatë në AMTP, me sipërfaqe 4500 m² dhe 1270 m² në llojin e pasurisë “Arë”, përputhet me AMTP-në me nr. Akti 128, datë 08.04.2003, si dhe si dhe pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative për Fshatin Linz, hartën e ish-kooperativës bujqësore të shk. 1:5000, hartën e shk. 1:2500, dhe librin e ngastrës, për të provuar vërtitësin e llojit të pasurisë.

-Nga Njësia Administrative Dajt është miratuar plan-rilevimi për ngastrën e renditur në rreshtin e gjashtë të AMTP-së me nr. Akti 128, datë 08.04.2003, me emërtimin popullor “Linz” me sipërfaqe 2250 m² duke ndryshuar llojin e pasurisë nga “Pyll” në “Arë” ku me shkresën nr. 552/1, datë 19.02.2021 nga Njësia Administrative Dajt është dërguar për regjistrim pasuria publike në emër të Z. H. D.

Spektori i regjistrimit pranë Drejtoria Vendore ASHK Tirana Rurale 1, bazuar në dokumentacionin e dërguar me shkresën nr. 552/1, datë 19.02.2021 nga Njësia Administrative Dajt, është regjistruar pasurinë në emër të z. H. D me nr. Pasurie 505/361, në vol. 64, faqe 11, Z.K. 2460, duke ndryshuar llojin e pasurisë nga “pyll” në llojin e pasurisë “arë” më sipërfaqe 2250 m², Fshati Linz, ky dokument regjistrimi ka marre numrin e referencës 000020863.

18. Praktika e kryefamiljarit Z. F. I

Me shkresën nr. 51/1 prot., datë 12.07.2021 nga ana e Njësisë Administrative Dajt është përcjell dokumentacioni DV ASHK-së Tirana Rurale 1, në bazë të kërkesës së paraqitur nga F. I me datë 08.01.2019 e protokolluar me nr.51 prot., fshati Surrel, Z.K. 3550.

Në shkresën drejtuar Drejtoria Vendore ASHK Tirana Rurale 1 citohet se, referuar kërkesës së qytetarit si dhe mbështetur në shkresën e Bashkisë Tiranë drejtuar Njësisë Administrative Dajt

me nr. 51 prot., datë 08.01.2019 si dhe në mbështetje të shkresave të DV ASHK-së përkatësisht me nr. 9645 prot., datë 28.12.2020 dhe me nr. 968 prot., datë 09.02.2021 dhe nr. 497 prot. Datë 10.02.2021 sipas të cilës në zbatim të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” neni 14. Si dhe në bazë të të VKM nr. 1174 datë 24.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve si dhe normat për sipërfaqet shtesë e pronat shërbyese” bashkëlidhur citohet ne shkresë po ju bashkëlidhim praktiken e përbërë me këto dokumente:

1.AMTP (fotokopje) plus Dublikatë.

2.Plan vendosjen e pasurisë me nr.151/17, 151/5 në shk:1:2500.

3.Certifikata e gjendjes civile të banorit datë 01.08.1991

4.Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë Tiranë me nr.39203/1 datë 17.10.2019

5. Shkresa e Bashkisë dhe DV ASHK-së për dërgim dokumentacioni

6.Kërkesa e qytetarit për regjistrim drejtuar Njesisë Administrative Dajt.

Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi “Dublikate” që mban datën 10.02.2020 i plotësuar dhe i konfirmuar nga Administratori i Njesisë Administrative Dajt, Z. K. Q, është bazuar në VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, në këtë AMTP i janë dhënë kryefamiljarit Z. F. I një sipërfaqe tokë bujqësore ne total 9880 m² e ndarë në 2 ngastra me emërtimin popullorë, “Fusha” me nr. 151 me sipërfaqe 6575 tokë “arë” dhe në ngastrën me emërtimin popullorë përsëri “Fusha” me nr. 151 me sipërfaqe 3305 tokë “arë”.

Bazuar në AMTP-në Dublikatë janë përgatitur edhe 2 plan rievimet nga topografi me licencë, nga Studio ST.TOP. Konsulencë Juridike me Lic. Nr. T0552/1 datë 12.07.2012, pa datë përgatitje, ky plan rievimi është miratuar nga Kryetari i Fshatit Surrel Z. F. T dhe nga Administratori i Njesisë Administrative Dajt.

Nga ana e specialistit të ZAMIT-së Njësia Administrative Dajt rezulton të mos jetë verifikuar në formularin nr.6, për 2 ngastrat me emërtimin popullorë, “Fusha” me nr. 151 me sipërfaqe 6575 tokë “arë” dhe për ngastrën tjetër po me të njëjtin emër “Fusha” me nr. 151 me sipërfaqe 3305 tokë “arë” të plotësuara në ish-AMTP-në nga ish-komisioni i ndarjes së tokës, që është fotokopje dhe e pa numër akti dhe pa datë plotësimi.

Nisur nga vlefshmëria ligjore e titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, AMTP-së “Dublikatë” që mban datën 10.02.2020 i konfirmuar nga Administratori i Njesisë Administrative Dajt, rezulton se ajo nuk është e konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, me nr.39203/1 datë 17.10.2019, “Për një shtesë në urdhrin nr.26474/1 datë 02.09.2019 “Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësia Administrative ...” për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të pronësie të rijnë të pronësisë mbi tokën bujqësore...”, në kundërshtim me piken 4.1 germa “a” ku citohet se “*Të gjithë procedurat e ndjekur nga Administratori i Njesisë Administrative do të verifikohet nga Sektori i AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.*”

Nga Administratori i Njesisë Administrative Dajt është dërguar AMTP-së “Dublikatë” direkt për regjistrim pa kaluar më parë në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë, ku në formatin e formularit të AMTP-së Dublikatë mungon miratimi i Kryetarit të Bashkisë Tiranë, që do të thotë së, në bazë të nenit 109, të Ligjit nr. 44/2015 “Për Kodin e Procedurës Administrative” është një akt administrativ i paligjshëm, ku paligjshmëria është rezultat i miratimit të AMTP-së Dublikatë në kundërshtim me ligjin material.

Nga Njësia Administrative Dajt është përcjellë për në Drejtoria Vendore ASHK Tirana Rurale 1, plani i rievimit i hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke mos përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”, në kundërshtim me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

Sektori i regjistrimit pranë Drejtoria Vendore ASHK Tirana Rurale 1, bazuar në dokumentacionin e dërguar me shkresën nr. 51/1 prot., datë 12.07.2021 nga Njësia Administrative Dajt, është regjistruar 2 pasuri në emër të Z. F. I ku formati i formularit të AMTP-së është “**Dublikatë**” i pa miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, me nr.39203/1 datë 17.10.2019, “Për një shtesë në urdhrin nr.26474/1 datë 02.09.2019 “Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësia Administrative ...” për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të pronësisë të rijnë të pronësisë mbi tokën bujqësore...”, në kundërshtim me piken 4.1 germa “a” ku citohet se: “*Të gjithë procedurat e ndjekur nga Administratori i Njesisë Administrative do të verifikohet nga Sektori i AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.*”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas praktikave ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Z. K. Q**, me detyrë, Administrator i Njesisë Administrative Dajt.
2. **Z. R. M**, me detyrë, Përgjegjës i ZMMT-së
3. **Znj. J. GJ**, me detyrë, Specialist i ZAMIT-së.
4. **Z. B. T**, me detyrë, Specialist i ZAMIT-së.
5. **Z. K. R**, me detyrë Specialist i ZAMT-së.
6. **Z. A. L**, me detyrë Topograf

Për sa është trajtuar, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 850/3prot, datë 12.5.2023 i administruar në KLSH me nr.796/16 prot., datë 17.5.2023, “*Mbi Projekt-Raportin e Auditimit*” dërguar nga z. K. Q me detyrë administrator Njësia Administrative Dajt, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me Projekt-Raportin e Auditimit në Njesisë Administrative Dajt dhe në bazë të rekomandimeve të lëna nga institucioni juaj ju bejmë me dije përgjigjen e dhënë nga të gjithë punonjësit e atakuar nga ky projekt raport auditimi. Për sa më si poshtë:

Lidhur me konkluzionet tuaj se strukturat drejtuese të Njesisë Administrative Dajt, janë përgjegjëse për konfirmimin e AMTP-ve ju bejmë me dije se në asnjë moment as rast nuk është parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore konfirmimi i AMTP-ve nga struktura e Njesisë Administrative Dajt, pasi AMTP-ja është një akt administrativ i dal nga një organ kolegjal dhe si i tillë nuk është parashikuar konfirmimi nga Njesisë Administrative. Staf i drejtues gjithmonë ka qenë korrekt dhe kohërent në përputhje me politikën, ligjet në fuqi.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në asnjë rast grupi i auditimit nuk ka bërë me përgjegjësi Njësia Administrative për aktet administrative të nxjerra nga ish-komisioni i ndarjes së tokës të vitit 1992, e në vazhdim. por në të gjitha rastet përgjegjësia bie mbi ish-komisionin e ndarjes së tokës për të cilin ka plotësuar AMTP-të në kundërshtim me VKM nr. 230, datë 22.7.1991, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e komisioneve të tokave”, të ndryshuar dhe në udhëzimin nr.2, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin e komisioneve të tokës në rrethet e fshatra”.

Për sa më sipër observacioni në lidhje me komentin e paraqitur **merret në konsideratë** pjesa e mos përgjegjësisë të Njesisë Administrative Dajt në lidhje me plotësimin e AMTP-ve.

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me Gjetjen numër 1 të auditimit, ku nga Njësia Administrative Dajt, është pranuar kërkesa e z. H. D për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, pa verifikuar formularin nr.6, nëse ngastrat me emërtimin popullor “Linz” rreshti i gjashtë dhe shtatë në AMTP, me sipërfaqe

4500 m² dhe 1270 m² në llojin e pasurisë “Arë”, përputhet me AMTP-në me nr.Akti 128, datë 08.04.2003, si dhe si dhe pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative për Fshatin Linz, hartën e ish-kooperativës bujqësore të shk. 1:5000, hartën e shk. 1:2500, dhe librin e ngastrës, për të provuar vërtetësinë e llojit të pasurisë Përgjigjia nga Njësia Administrative Dajt: Lidhur me rekomandimin e lënë për sa më sipër ju bëjmë me dije se nga Njësia Administrative Dajt do të vazhdojë korespondencën me institucionin e ASHK-së Rurale Tirana 1.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Për sa më sipër në lidhje me Gjetjen numër 1 të auditimit, nga Njësia Administrative Dajt është pranuar gjetja për rrjedhoj edhe rekomandimi i lënë është në proces realizimi.

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me Gjetjen numër 2 të auditimit nga Administratori i Njesisë Administrative Dajt është dërguar AMTP-së “Dublikatë” direkt për regjistrim pa kaluar më parë në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë, ku në foramin e formalrit të AMTP-së Dublikatë mungon miratimi i Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Për sa më sipër në lidhje me Gjetjen numër 2 të auditimit, nga Njësia Administrative Dajt është pranuar si gjetja për rrjedhoj komenti i paraqitur **merret në konsideratë**.

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me Gjetjen numër 4 të auditimit nga Administratori i Njesisë Administrative Dajt bënë me dije se bazuar në ligjin nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” për të drejtat që i kanë kaluar ASHK, Njësia Administrative Dajt nuk ka asnjë tagër për dërgimin e planëve të rilevimit të subjekteve të cituar pasi tashmë kërkesat bëhen online, nëpërmjet portalit qeviratar e-albania.

Qëndrimi i Grupit të auditimit

Në lidhje me komentet dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i audituar, sqarojmë se ligjin nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” ka dalë që me datë 5.3.2020, ndërsa shkresa me nr. 3802/1 prot., datë 22.12.2020 është dërguar nga Njësia Administrative Dajt me datë 22.12.2020 në drejtim të DV ASHK-së Tirana Rurale 1.

Në këto kushte Observacioni në lidhje me komentin e paraqitur **nuk merret në konsideratë**.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast nga Njësia Administrative Dajt, është pranuar kërkesa e z. H. D për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, pa verifikuar formularin nr.6, nëse ngastra me emërtimin popullor “Linz” rreshti i gjashtë dhe shtatë në AMTP, me sipërfaqe 4500 m² dhe 1270 m² në llojin e pasurisë “Arë”, përputhet me AMTP-në me nr.Akti 128, datë 08.04.2003, si dhe pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative për Fshatin Linz, hartën e ish-kooperativës bujqësore të shk. 1:5000, hartën e shk. 1:2500, dhe librin e ngastrës, për të provuar vërtetësinë e llojit të pasurisë (Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt, të kërkoje pranë DV ASHK Rurale 1, anulimin e regjistrimit të dërguar me shkresën nr. 552/1, datë 19.02.2021, për regjistrimin e pasurisë “pyll” në emër të z. H. D, ku pasuria nr Pasurie 505/361, regjistruar në vol.64, faqe 11, Z.K. 2460 nga lloji i pasurisë “pyll” më sipërfaqe 2250 m², Fshati Linz, të rikthehet në pasuri “shtet”

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast nga Administratori i Njesisë Administrative Dajt është dërguar AMTP-ja “Dublikatë” direkt për regjistrim, pa kaluar më parë në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë, ku në formatin e formularit të AMTP-së **Dublikatë** mungon miratimi i Kryetarit të Bashkisë Tiranë, që do të thotë se në bazë të nenit 109, të Ligjit nr. 44/2015 “Për Kodin e Procedurës Administrative”, është një akt administrativ i paligjshëm, ku paligjshmëria është rezultat i miratimit të AMTP-së Dublikatë (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Në gjitha rastet për kryerjen e procedurave që lidhen me titujve të rinjë të pronësisë mbi tokën mbi tokën bujqësore, kur AMTP-ja do të plotësohet “Dublikatë”, Njësia Administrative Dajt duhet të dërgoj AMTP-në për verifikim dhe miratim në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në 6 raste, Njësia Administrative Dajt ka përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plani i rilevimit nuk është hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke mos përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”, në kundërshtim me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt të përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plan rilevimit të hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke përmbushur standardet teknike të përcaktuara dhe në modelet e akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga Njësia Administrative Dajt, është pranuar kërkesa e z. S. M për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa verifikuar më parë vlefshmërinë e ngastrës me emërtimin popullor “ullishte”, që bazuar në “kthim përgjigje të DV ASHK Tirana Rurale 1, rezulton në llojin e pasurisë tokë “Pyll” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt, para se të dërgoj AMTP-së dhe plan rilevimit për regjistrim, duhet që Specialisti i ZAMIT-së. të verifikoj formularin nr. 6, librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkalles 1:5000 para vitit 1991 për vlefshmërinë e ngastrës për zërin kadastral të pasurisë.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Njësia Administrative Dajt në vazhdimësi ka llogaritur si të ardhura nga tatimi për një rrënjë ullinj të barabartë me një sipërfaqe nga 80 m² deri 120 m², çfarë do të thotë se 30 rrënjë ullinj që posedon Z. M. E, është e barabartë me (max.) 3600 m², (120 m² x 30 rrënjë ullinj = 3600 m²), ndërsa kërkesën e Z. R. E është miratuar me sipërfaqe 5960 m² sipas Plan rilevimit i hartuar me datë 15.02.2021 nga topografi i Njesisë Administrative Dajt i konfirmuar nga Përgjegjësi i ZMMT dhe i miratuar nga Administratori i Njesisë Administrative Dajt (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt në të gjitha rastet të përdorë një standard në llogaritjen e të ardhurave nga tatimi për një rrënjë ullinj të barabartë me një sipërfaqe nga 80 m² deri 120 m².

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në 10 raste, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore më shumë se sa është përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Komunës, duke tejkalar normën për frymë, në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me ligjit 20/2020 dhe ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt në të gjitha rastet para se të përcjell dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë normën për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast, përfituesi i AMTP-së, i plotësuar në emër të **znj. N. B** nga ish-komisioni i ndarjes së tokës, Fshati Tufinë, nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore. Bazuar në certifikatën e gjendjes familjare të administruar në dosje, rezulton se familja bujqësore nuk ka qenë banore në territorin e i fshatit Tufinë, por është banore e fshatit Zall-Bastarë *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Dajt në të gjitha rastet para se të përcjell dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë legjitimitetin e AMTP-së në lidhje me përfitimin e tokës bujqësore, sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në 4 raste, nga ana e specialistit të ZAMIT-t të Njesisë Administrative Dajt, nuk është verifikuar pasuria në terren, por është referuar plan-rilevimit i përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit nuk ka saktësuar pasurinw sipas terrenit, por është referuar hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1, duke copëzuar pasurinë nr. 364/4 në tre pasuri të tjera “shtet”, krejtësisht të pashfrytëzueshëm, duke marr një konfigurim krejtësisht të ndryshëm nga fragmenti i hartës kadastrale, në kundërshtim me nenit 36, pika "b", të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën” *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Nga specialisti i ZAMIT-t të Njesisë Administrative Dajt në të gjitha rastet para se të miratohet plan rilevimin e përgatitur nga topografi me licencë, të verifikohet pasuria sipas terrenit dhe të shoqërohet me deklarata noteriale sipas rastit.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast mungon statusi juridik i pronës të pretenduar nga z. S. M e konfirmuar nga DV ASHK Rurale 1, për pasurinë nr. 322 për llojin e pasurisë (zërin kadastral), në çfarë volumi dhe faqe është regjistruar pasuria, si dhe në çfarë emri figuron e hapur kartela e pasurisë së paluajtshme. Nga ana e specialistit të ZAMIT-së Njësia Administrative Dajt, nuk është verifikuar në librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991, për ngastrën me pasurinë nr. 322 me zë kadastral “truall” me sipërfaqe 20700 m² *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 10-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Nga specialisti i ZAMIT-t të Njesisë Administrative Dajt, të verifikohet AMTP-ja, ku sipërfaqe e tokës që kalohet për regjistrim, duhet të përmbushë njëkohësisht, t'i përkasë një prej zë, rave të tokës bujqësore me qëllim konsolidimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi tokën bujqësore.

Në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tiranë** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe të kontratës individuale.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi (Tematik).

AUDITUESIT SHETETORË TË KLSH

K. GJ

S. S

P. GJ

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

B. D

KONTROLI I LARTË I SHETIT